# AKTIVITETI PARLAMENTAR DHE CILËSIA E PËRFAQËSIMIT

## RAPORT MONITORIMI I KUVENDIT 2022

Instituti i Studimeve Politike
www.isp.com.al

# AKTIVITETI PARLAMENTAR DHE CILËSIA E PËRFAQËSIMIT

## RAPORT MONITORIMI I KUVENDIT 2022

Tiranë, gusht 2022

Në funksion të projektit është realizuar aplikacioni online www.deputetim.al ku reflektohen të dhënat e vazhdueshme të monitorimit. Ky është raporti i dytë i monitorimit në kuadër të projektit.


ISP
INSTITUTI I STUDIMEVE POLITIKE
INSTITUTE FOR POLITICAL STUDIES
www.isp.com.al

## EKIPI REALIZUES

### Drejtues i projektit

Afrim Krasniqi

### Autorë të raportit

Altin Gjeta
Eno Muja

### Bashkëpunuan

Rudina Niklekaj
Brunilda Duriçi
Juljana Bilbilaj
Silvana Jaupaj
Rigels Xhemollari

### Kopertina dhe dizajni

M&P Studio

### ISBN 978-9928-4694-7-2

Projekt i mbështetur nga Agjencia Zvicerane
per Zhvillim dhe Bashkëpunim

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

**Swiss Agency for Development and Cooperation SDC**



Mendimet dhe pikëpamjet e shprehura në këtë raport janë përgjegjësi e ISP dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pozicionin zyrtar të Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim.

# PËRMBAJTJA E LËNDËS


**1. HYRJE** **5**

**2. GJETJET KRYESORE TË RAPORTIT** **7**

2.1 REKOMANDIMET KRYESORE 10

**3. KUVENDI, PËRFAQËSIMI DHE PROBLEMATIKA** **13**

3.1 KUVENDI NDRYSHON KUSHTETUTËN, MANDATI I ORGANEVE TË VETINGUT 13

3.2 NISMA KUSHTETUESE MBI VETINGUN NË POLITIKË, ENDE PA VENDIM 14

3.3 GJK RRËZIM I NISMËS PËR SHKARKIMIN E PRESIDENTIT 14

3.4 KOMISIONET E POSAÇME, PROGRES MINIMAL 15

3.5 NJË DEPUTET I BURGOSUR DHE DEBATI MBI KORRUPSIONIN 15

3.6 OPOZITA NË PARLAMENT? E PAQARTË DHE PROBLEMATIKE NË PËRFAQËSIM 16

3.7 "NON GRATA" DHE LISTA E SANKSIONEVE, PARLAMENTI NËN PRESION 17

3.8 FUNKSIONI LIGJVËNËS, STATISTIKA DHE PROBLEMATIKAT 18

3.9 KONTROLLI PARLAMENTAR, BILANCI GRI I KUVENDIT 18

3.10 FUNKSIONI ZGJEDHOR I KUVENDIT, MODELE E PROBLEMATIKA 19

**4. KUVENDI, TRANSPARENCA DHE PROBLEMATIKA** **21**

4.1 TRANSPARENCA: ARRITJE DHE PROBLEMATIKA 21

4.2 GRUPET PARLAMENTARE, MUNGESË TRANSPARENCE DHE LLOGARIDHËNIE 22

4.3 KOMISIONET PARLAMENTARE, BILANCI DHE PROBLEMATIKA 23

4.4 PJESËMARRJA KRITIKE E DEPUTETËVE NË SEANCAT PLENARE 24

4.5 KONFLIKTI I INTERESIT: DY HAPA PARA, NJË HAP PAS 24
4.6 ETIKA PARLAMENTARE, RASTE SHQETËSUESE DHE STANDARDE TË DYFISHTA 25
4.7 BURIMET MBËSHTETËSE PARLAMENTARE 26
4.8 NGRITJA E KAPACITETEVE TË KUVENDIT DHE DEPUTETËVE 26

**5. KLASIFIKIMI I EFIKASITETIT TË DEPUTETËVE (JANAR – KORRIK 2022) 27**
5.1 DEPUTETËT MË EFIKASË: TABAKU (PD) DHE BRAÇE (PS) 27
5.2 DEPUTETËT MË PAK EFIKASË 2022 29
5.3 DEPUTETËT ME MË SHUMË FJALIME VS ATA ME "0" FJALIME 30
5.4 MINISTRAT? SHUMICA MË SHUMË FJALIME SE KRYEMINISTRI 31

**6. RAPORT I MONITORIMIT TË MARRËDHËNIES SË INSTITUCIONEVE KRYESORE KUSHTETUESE DHE TË PAVARURA ME KUVENDIN 33**
6.1 GJETJET REFERUAR INSTITUCIONEVE PËR TË CILAT ËSHTË MIRATUAR REZOLUTË 35
6.2 KËRKESA TË TJERA PËR NDRYSHIME LIGJORE 37
6.3 KËRKESAT DREJTUAR KUVENDIT 41
6.4 DISKUTIMET GJATË RAPORTIMEVE TË INSTITUCIONEVE NË KUVEND 45
6.5 KËRKESAT DREJTUAR KUVENDIT NGA KËSHILLI DREJTUES I RTSH 47
6.6 KONKLUZIONE 47

**7. ANEKS ME TË DHËNA TË DETAJUARA 51**
7.1 TABELA ME RENDITJEN E DEPUTETËVE MBI BAZËN E KRITEREVE TË VLERËSIMIT 52
7.2 TABELA ME RENDITJEN E DEPUTETËVE MBI BAZËN E NUMRIT TE FJALIMEVE 55

# 1. HYRJE

Instituti i Studimeve Politike (ISP) me mbështetjen e Ambasadës së Zvicrës në Shqipëri po monitoron Kuvendin dhe aktivitetin parlamentar në Shqipëri. Qëllimi i monitorimit është njohja, evidentimi dhe promovimi i bilancit parlamentar, ekspozimi i rolit të Kuvendit në procesin ligjvënës, në kontrollin dhe monitorimin e ekzekutivit dhe institucioneve të tjera kushtetues si dhe në diplomacinë parlamentare; respektimin e standardeve të transparencës dhe të llogaridhënies, të përfaqësimit dhe të funksionit kushtetues të institucionit.

Projekti monitorues është vazhdim i monitorimit të mëparshëm të kryer nga ISP nga viti 2016, fillimisht me mbështetjen e FES (2016-2017) dhe më pas me mbështetjen e Ambasadës së Holandës në Shqipëri (2017-2020). Ambasada e Zvicrës në Shqipëri ka qenë dhe mbetet aktive në promovimin e rolit aktiv të shoqërisë civile në monitorimin e proceseve demokratike, vendimmarrëse dhe përfaqësuese në Shqipëri. Qeveria zvicerane ka një program të gjerë asistence dhe mbështetje të kapaciteteve të Kuvendit, projekt që po zbatohet nga bashkëpunimi midis OSBE dhe NDI. ISP është mbështetur në disa nisma nga programe të financuara nga qeveria zvicerane, kryesisht në monitorimin e qeverisjes vendore dhe përfaqësimit politik në këshillat bashkiakë të qarkut Tiranë.

Projekti aktual shtrihet deri në vitin 2023 dhe në funksion të tij është edhe platforma online www.deputetim.al ku janë të pasqyruara raportet tona të monitorimit, aktiviteti parlamentar, të dhënat për deputetët, treguesit e efikasitetit të tyre, fjalimet e mbajtura dhe të dhëna të tjera specifike. Database është në plotësim të vazhdueshëm me të dhëna të reja që dalin nga monitorimi.

Një prej risive të monitorimit të kryer nga ISP është përpjekja për të evidentuar nivelin e efektivitetit të deputetëve mbi bazë të kontributeve personale, mbi bazën e grupeve politike, mbi bazën e gjinisë dhe mbi bazën e përfaqësimit elektoral dhe përvojës parlamentare. Risi tjetër e këtij raporti është vlerësimi paraprak i monitorimit të funksionit kontrollues të Kuvendit në raport me institucionet e pavarura dhe ato të krijuara me ligj, funksionit zgjedhor, si zgjedhja e Presidentit të Republikës, Avokatit të Popullit dhe krerëve të tjerë të institucioneve të pavarura kushtetuese në vend.

Përveç procesit monitorues ISP i është përgjigjur pozitivisht të gjitha ftesave të ardhura nga Kuvendi për konsultime publike apo pjesëmarrje në seanca dëgjimore, përfshirë nismat për ndryshime kushtetuese, si dhe ka organizuar disa aktivitete (trajnime dhe konferenca) me pjesëmarrjen e deputetëve nga grupe të ndryshme parlamentare. ISP falënderon kryetaren e Kuvendit, drejtuesit e grupeve parlamentare dhe drejtuesit e administratës në Kuvend për bashkëpunimin korrekt dhe mbështetjen e aktivitetit tonë monitorues.

ISP do të vijojë monitorimin e Kuvendit dhe raportimin publik deri në sesionin e parë të vitit 2023. Raporti i tretë do të bëhet publik në fillim të janarit 2023, si pasqyrim i punës së Kuvendit në sesionin e ardhshëm shtator-dhjetor 2022.

# 2. GJETJET KRYESORE TË RAPORTIT

- Gjatë sesionit parlamentar janar – korrik 2022 Kuvendi iu rikthye normalitetit formal, me pjesëmarrje aktive të të gjitha prurjeve politike, përfshirë opozitën, e cila në sesionin e kaluar më shumë u investua në debatet e brendshme politike, sesa në përfaqësimin parlamentar. Temat kryesore në ligjërimin dhe nismat parlamentare mbeten vetingu në politikë, reforma në drejtësi, lidhjet e politikës me krimin, korrupsioni, rritja e kostos së jetesës dhe skandale si ai i inceneratorëve, për të cilin dy deputetë të zgjedhur më 2021 janë në burg.

- Retorika parlamentare u bazua kryesisht në sulme të personalizuara dhe akuza të ndërsjellta, me gjuhë denigruese dhe mungesë të respektit ndaj mendimeve të Tjetrit, sjellje partizane dhe imponim të votave të shumicës për vendimmarrjet politike. Megjithë praktikën e seancave dedikuar zgjedhësve, në tërësi diskutimet parlamentare lanë në hije problematikat e tyre duke u fokusuar në debatet politike të ditës.

- Tri aktet më të rëndësishme të parlamentit gjatë sesionit janar – korrik 2022 ishin: zgjedhja e Presidentit të ri të Republikës, ndryshimi i kushtetutës lidhur me mandatet e organeve të vetingut, dhe funksionimi i komisionit hetimor për inceneratorët.

- Gjatë sesionit nuk pati mocion besimi dhe as mosbesimi, nuk pati seancë të posaçme pyetjesh për kryeministrin, dhe megjithëse u shënuan 19 interpelanca, në tërësi, Kuvendi nuk arriti të bëjë progres në jetësimin e funksionit kushtetues të kontrollit të pushtetit ekzekutiv.

- Klima e tensionit, arroganca e shumicës parlamentare dhe sjellja agresive e opozitës dobësuan cilësinë e debatit parlamentar dhe vështirësuan moderimin e punimeve të Kuvendit. Megjithëse drejtimi aktual i parlamentit, në dallim nga disa legjislatura të kaluara, nuk provokon incidente dhe konflikte parlamentare, deputetët nuk e konsiderojnë këtë si një mundësi pozitive për sjellje më konstruktive. Drejtuesit e grupeve parlamentare nuk kanë arritur të ndikojnë në moderimin e debatit parlamentar dhe roli i ministrit për parlamentin shënoi regres të dukshëm në raport me përgjegjësitë kushtetuese dhe pritshmëritë publike.

- Zgjatja e mandatit të organeve të vetingut është një hap pozitiv për vijimin e zbatimit të reformës në drejtësi, por votimi në Kuvend pa një raport analitik të problemeve të

shfaqura tregon edhe njëherë se mungon tradita e shqyrtimit post-legjislativ. Komisionet e posaçme, zgjedhore dhe ai i reformës territorial u ngritën me vonesë dhe nuk kanë bërë progres të dukshëm në agjendën e tyre. Zgjatja e mandateve kohore vijon të jetë shqetësim kritik ndërkohë që parlamenti nuk ka një sistem efektiv të respektimit të afateve dhe vendimeve të tij.

- Nisma kushtetuese për veting në politikë vijon të jetë në agjendë, megjithëse gjerësisht konsiderohet si nismë për konsum politik, sesa për të forcuar luftën ndaj korrupsionit, sistemin e transparencës dhe të llogaridhënies. Megjithatë, deri në fund të sesionit parlamenti nuk arriti të marrë një vendim shterues lidhur me këtë nismë.

- Kuvendi miratoi një numër të madh aktesh ligjore (sipas database 61 ligje, 29 rezoluta dhe 64 vendime), por shumica e tyre ishin akte procedurale apo amendime ligjore. Asnjë ligj i rëndësishëm që lidhet me reformat nuk ishte pjesë e agjendës. Qeveria vijon të ketë monopolin e nismave ligjore, duke vijuar traditën sipas të cilës, Kuvendi mbetet pasiv në procesin legjislativ. Midis nismave parlamentare të deputetëve, ato më konstruktivet u refuzuan, një sinjal dekurajues për ushtrimin më të madh të të drejtës ligjvënëse, sidomos të atyre që nuk bëjnë pjesë në grupin politik të shumicës.

- Arritja më e rëndësishme e këtij sesioni në aspektin e komisioneve hetimore ishte komisioni për inceneratorët. Komisioni ka zhvilluar 19 seanca dëgjimore dhe mori në pyetje një numër të madh zyrtarësh të lartë, përfshirë kryeministrin dhe disa kryetarë bashkish. Punimet e komisionit u pasqyruan gjerësisht nga media, publiku tregoi interes të madh, dëshmitë sollën të dhëna me interes hetimor nga SPAK dhe, pavarësisht se nuk pati dakordësi në raportin e Komisionit, praktika e tij mbetet një arritje domethënëse dhe një ilustrim se si ushtrohet hetimi dhe kontrolli parlamentar nga pakica politike.

- Kriza në PD ka pasur ndikim në të gjithë aktivitetin, performancën dhe jetën parlamentarë, sidomos në agjendën e opozitës dhe të deputetëve në mënyrë individuale. Kuvendi nuk ka një sistem efektiv që bën verifikimin e legjitimitetit të grupeve parlamentare dhe mazhoranca krijoi përshtypjen se dëshiron të përdor shumicën e saj për të diktuar opozitën. Ajo refuzoi nisma serioze të ardhura nga deputetë të tjerë, të cilët sipas saj, nuk përfaqësojnë opozitën ligjore, megjithëse sipas Kushtetutës, çdo deputet është i barabartë në të drejtën për nisma ligjore dhe se të gjithë deputetët kanë të njëjtin burim legjitimiteti nga zgjedhjet parlamentare të vitit 2021.

- Kriza në përfaqësimin e opozitës i harxhoi asaj energji të shumta dhe krijoi perceptimin se deputetët votojnë dhe mbajnë qëndrime më shumë nga dëshirat e tyre, sesa nga një platformë politike kolektive. Përfaqësimi i saj në organet parlamentare, përfshirë drejtimi në komisione, me përjashtim të komisionit hetimor, ishte cilësisht i dobët, duke ndikuar në dobësimin e rolit dhe funksionit kushtetues të parlamentit.

- Partia Socialiste siguroi në vijueshmëri votat e PSD, duke krijuar perceptimin se janë e njëjta parti, ndërkohë që disa deputetë me përvojë parlamentare në PS u bënë zëra kritikë në nisma ligjore, debate e akte parlamentare me rëndësi publike, një vlerë pozitive e legjislaturës aktuale parlamentare. Një deputet i PS u arrestua për korrupsion, duke dhënë dorëheqjen, disa deputetë të tjerë janë ende në procese hetimore.

- Kuvendi zgjodhi Presidentin e Republikës, por procesi ishte thuajse formal: tre raunde nuk pati votim dhe as kandidat, në votimin e katërt votimi u kthye më shumë në konfirmim emërimi. Mazhoranca e dobësoi parlamentin kur vendosi të votojë në grupin e saj parlamentar kandidatët e mundshëm për President, kurse opozita e dobësoi procesin kur refuzoi të drejtën kushtetuese të propozimit të kandidatëve për President.

- Kuvendi nuk respektoi afatet ligjore për rotacionet në institucionet që dalin nga Kuvendi dhe në tërësi, në rastet zgjedhore pati vetëm një kandidat në garë. Procedurat e konkurrimit dhe të meritokracisë u zbehën nga vendimmarrja paraprake politike dhe se procesi i raportimit vjetor të institucioneve në Kuvend reflektoi preferencat politike. Në seancat dëgjimore nuk pati adresim të shqetësimeve të shoqërisë civile dhe as ftesë pjesëmarrje për to. Sistemi online i platformës institucionale nuk ishte funksional dhe me gjithë premtimet se do të ishte risi në procesin e transparencës dhe llogaridhënies Kuvendi dështoi ta jetësojë atë.

- Respektimi i Kodit të Etikës, sidomos në ligjërimin parlamentar dhe në deklarimin e konfliktit të interesit dhe të sistemit të dhuratave apo deklarimeve në veprimtari të të tretëve, në tërësi nuk u respektua. Gjatë sesionit pati raste të shumta të gjuhës fyese e denigruese ndaj Tjetrit, shkelje të etikës në komunikim, vetëm 6 deklarime të konfliktit të interesit ndërkohë që një proces vlerësimi ndaj ministres së jashtme vijon të jetë në procedurë parlamentare, si dhe asnjë deklarim për pjesëmarrje të deputetëve në veprimtari të organizuara nga të tretët.

- Kuvendi ka bërë progres minimal në drejtim të rritjes së transparencës në veprimtarinë e vet, kryesisht përmes zhvillimit të mbledhjeve të komisioneve online me akses për publikun, si dhe në publikimin e të dhënave të detajuara lidhur me seancat plenare. Kategori të tjera, si thirrjet për vende vakante, gara midis tyre, të dhënat e kandidatëve, formularët e dekriminalizimit, si dhe publikimi në kohë i procesverbaleve dhe të dhënave financiare, vijojnë të jenë larg standardeve të "open parlament". Gjatë gjithë sesionit faqja online e Kuvendit vijoi të ishte nën logon "në ndërtim e sipër", duke krijuar idenë e gabuar se çdo shqetësim e problematikë është e justifikueshme.

- Në vlerësimin e efikasitetit gjatë sesionit parlamentar deputetët me nivelin më të lartë u konfirmuan Jorida Tabaku (PD) dhe Erion Braçe (PS), dy deputetë me vlerësim maksimal edhe në sesionet e kaluara parlamentare. Disa nga deputetët e rinj patën rritje të vizibilitetit dhe aktivitetit parlamentar, ndërkohë që së paku 17 deputetë nuk arritën dot

të mbajnë një fjalim në parlament. Gratë deputete ishin shumë më aktive, sesa deputetët burra (35 vs 33 nga 100 pikë në nivel krahasues në parlament me deputetët meshkuj). Në nivel grupesh, deputetët e LSI patën koefiçientin më të lartë të efikasitetit (37 nga 100 pikë), ndjekur nga deputetët e PD (35 nga 100 pikë) dhe PS (34 nga 100 pikë). Grupi i deputetëve të PSD me vetëm 19 nga 100 pikë kanë pasur aktivitet minimal, duke mos pasur asnjë diskutim në komisione dhe as në seanca plenare, si dhe duke mos përdorur asnjë prej mekanizmave ligjvënës e përfaqësues që ofron Kuvendi.

- Kuvendi u investua edhe gjatë këtij sesioni në aktivitetin e Institutit Parlamentar, i cili gjithsesi, përveç raportimeve mbi aktivitete sensibilizues, informuese apo kërkimore, nuk ka të dhëna dhe as produkte online të verifikueshme. Revista "Kuvendi" vijon publikimin, megjithëse prurjet studimore nga deputetët janë minimale, një shqetësim për nivelin profesional dhe njohuritë parlamentare të vetë deputetëve.

## 2.1 REKOMANDIMET KRYESORE

I. Kuvendi mund të ndërtojë një agjendë afatgjate reformash, agjendë ligjvënëse dhe kontrolli kushtetues, që të mundësojë një rol më aktiv dhe thelbësor të tij në ushtrimin e funksioneve kushtetuese. Praktika e agjendave afatshkurtra të diktuara nga emergjenca dhe detyrime procedurale e dobëson rolin e parlamentit, besimin institucional dhe sistemin përfaqësues politik në vend.

II. Kuvendi duhet të krijojë standarde transparence dhe llogaridhënie të krahasueshme jo me legjislaturat e kaluara, por me standardet e vendeve të BE-së. Përmes programit PACEP është duke u punuar për të adresuar këtë çështje, duke përfshirë standarde të transparencës bazuar në praktikat ndërkombëtare. Hapja e bisedimeve për anëtarësim duhet të reflektohet në një qasje të re institucionale të parlamentit, standarde të reja dhe një sens më të madh përgjegjësie në përfaqësim, në funksionim, në vendimmarrje dhe në raport me publikun.

III. Kuvendi duhet t'i jap fund praktikës së vonesave të funksionimit të komisioneve të posaçme, si dhe të krijojë mekanizma funksionale për këto komisione, sidomos për komisionin e reformës zgjedhore dhe atë të reformës territoriale, të cilat kanë impakt me rëndësi për zgjedhjet e ardhshme lokale. Rishikimi i legjislacionit për komisionet e posaçme dhe ato hetimore, për ti bërë ato më funksionale dhe më efikase, do të duhet të jetë pjesë e prioriteteve strategjike të Kuvendit.

IV. Kuvendi duhet të bëjë përpjekje serioze për të zëvendësuar retorikat politike ditore në akte parlamentare, për të respektuar mendimin kritik dhe pakicën parlamentare, për të jetësuar një sistem sa më konsensual vendimmarrës për ligje e vendime që lidhen me interesat publike dhe reformat e rëndësishme, si dhe për të ushtruar funksionin thelbë-

sor kushtetues, kontrollin e pushtetit ekzekutiv.

V. Kuvendi duhet të reformojë rregullat e veta funksionale dhe ligjin mbi statutin e deputetit, për t'i bërë ato më bashkëkohore dhe funksionale dhe në funksion të transparencës, llogaridhënies dhe përgjegjësisë politike e publike.

VI. Kuvendi duhet të investohet në forcimin e rolit të vet në procesin ligjvënës. Deputetët sugjerohet të jenë më proaktivë dhe të ndërmarrin nisma ligjore, të bëjnë amendamente dhe propozojnë akte parlamentare, si dhe Kuvendi të ofrojë asistencë më cilësore ligjore dhe institucionale për ta. Deputetët sugjerohet të ndërmarrin më shumë nisma për komisione hetimore dhe të nxiten për përfundime konsensuale, për t'i bërë instrumentet parlamentare më të besueshëm dhe më funksionalë.

VII. Lidhur me funksionin zgjedhor, Kuvendi duhet të jetë institucion model për respektimin e afateve ligjore, të sistemit të meritokracisë, të transparencës për kandidatët dhe procesin konkurrues, si dhe të synojë shndërrimin e këtij procesi në konkurrencë të hapur larg votimeve formale të paravendosura.

VIII. Kuvendi duhet të reformojë platformën institucionale dhe mekanizmin e raportimeve vjetore të institucioneve, për të siguruar më shumë konsultime dhe llogaridhënie, si dhe elementë ndërveprimi që korrektojnë institucionet, Kuvendin dhe hendekun midis vlerësimit të institucioneve për vetveten dhe vlerësimin që vjen nga publiku.

IX. Kuvendi duhet të nxisë, të monitorojë dhe të imponojë respektimin integral të Kodit të Sjelljes në të gjithë elementët e tij, të promovojë etikën institucionale dhe të hetojë rastet e konfliktit të interesit dhe pjesëmarrjen në lobingje apo aktiviteteve të të tretëve.

X. Në funksion të rritjes së transparencës, Kuvendi duhet të përditësojë rregullisht faqen e Kuvendit, të publikojë në kohë procesverbalet e mbledhjes së komisioneve parlamentare, deklaratat e pasurisë dhe formularët e dekriminalizimit, CV e kandidatëve dhe çdo akt tjetër që lidhet me aktivitetin parlamentar. Transparenca dhe llogaridhënia është në interes të publikut, procesit ligjvënës dhe rritjes së besimit publik tek Kuvendi.

XI. Kuvendi duhet të ofrojë trajnime të vazhdueshme të deputetëve mbi rregulloren e Kuvendit, instrumentet e kontrollit parlamentar, legjislacionin dhe procesin e mbikëqyrjes parlamentare dhe post legjislative. Kuvendi mund të konsiderojë rritjen e asistencës teknike dhe financiare për deputetët në aktivitetin e tyre parlamentar, të forcojë komponentin e angazhimit të deputetëve në zonat elektorale, si dhe të sigurojë plotësimin në kohë e cilësi të të gjitha kërkesave të deputetëve që lidhen me ushtrimin e funksioneve të tyre kushtetuese dhe legjislative.

# 3. KUVENDI, PËRFAQËSIMI DHE PROBLEMATIKA

Kuvendi i Shqipërisë hapi punimet e sesionit të II-të të legjislaturës së X-të në 17 janar 2022 dhe i përfundoi me seancën e betimit të Presidentit të ri të Republikës. Gjatë kësaj faze parlamenti u dominua nga retorika të ashpra politike që lidhen me akuzat për korrupsion, për politikanët "non grata", për njësimin e institucioneve me partinë e shumicës, për personalizim të pushtetit dhe të politikës, për krizën në opozitë dhe për qëndrime preferenciale në politikën e jashtme.

Në thelbin e tij diskursi parlamentar ishte larg pritshmërive publike dhe nevojës për një parlament solid dhe ligjvënës, që reflekton sa kontrollin e pushtetit ekzekutiv aq edhe sjelljen konstruktive të opozitës. Palët politike krijuan perceptimin se vendi vijon fushatat elektorale edhe pse gjatë vitit 2022 nuk kishte zgjedhje kombëtare, dhe se preferencat personale të politikanëve imponuan agjendën dhe vendimmarrjen parlamentare.

## 3.1 KUVENDI NDRYSHON KUSHTETUTËN, MANDATI I ORGANEVE TË VETINGUT

Në muajin shkurt Kuvendi miratoi me 118 vota pro zgjatjen e mandatit të organeve të vetingut, Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe Komisionerëve Publik[1]. Një pjesë e opozitës u shpreh kundër, ndërkohë që seancat dëgjimore me shoqërinë civile, në të cilat u përfaqësua edhe ISP, krahas mbështetjes për ndryshimin kushtetues rekomanduan një qasje më strategjike të Kuvendit, analizë të gjendjes dhe ndërhyrje afatgjata.

Nën presionin pozitiv perëndimor Kuvendi siguroi mbështetjen e nevojshme për ndryshimin kushtetues, ndërhyrje që shmang krizën afatshkurtër, por nuk zgjidh problematikat ende të diskutueshme lidhur me jetësimin e vetingut dhe reformës në drejtësi. Zgjatja edhe për dy vite të tjera e mandatit të organeve të vetingut është hap pozitiv për shmangien e ngërçit të mundshëm dhe tregues mbështetjeje politike për përmbylljen e reformës në drejtësi. Megjithatë, fakti që Kuvendi nuk shqyrtoj mangësitë e shfaqura në procesin e vetingut, dhe as nuk ka një qasje monitoruese, rekomanduese dhe konstruktive për reformën, tregon se institucioni nuk ka arritur akoma të implementojë standardet e analizës dhe shqyrtimit post-legjislativ.

[1] "Kuvendi miraton me 118 vota pro zgjatjen e afateve për organet e Vetingut", Panorama.al, 10 shkurt 2022. http://www.panorama.com.al/lajmi-i-fundit-kuvendi-miraton-me-118-vota-pro-zgjatjen-e-afateve-per-organet-e-vetingut/

## 3.2 NISMA KUSHTETUESE MBI VETINGUN NË POLITIKË, ENDE PA VENDIM

Një nismë tjetër kushtetuese nga deputetët, lidhur me vetingun në politikë, ndonëse u bë pjesë e procedurës parlamentare, nuk ka arritur të prodhojë një vendimmarrje finale parlamentare. ISP ishte një prej organizatave që u ftua në parlament për të dhënë opinionin e saj lidhur me nismën[2], por në tërësi procedura e konsultimit me aktorët e shoqërisë civile ishte e shpejtë dhe mbeti formale. Kuvendi iu la vetëm 2 ditë kohë në dispozicion organizatave të shoqërisë civile dhe botës akademike për të dhënë opinione mbi një draft të rëndësishëm që synonte të prekte kushtetutën. ISP vlerësoi se vetingu në politikë mund të jetësohej edhe pa ndryshime kushtetuese, dhe do të përbënte akt radikal transformues për klasë politike, parlamentarizmin dhe jetën politike dhe sociale në vend[3], por, mungesa e vullnetit politik në Kuvend nga të gjithë krahët, e bëri të pamundur jetësimin e tij në praktikë.

ISP duke qenë kritike lidhur me përdorimin dhe synimin politik të nismës, rekomandoi se reforma të tilla kushtetuese kërkojnë kohë, konsultime të hapura dhe profesionale me ekspertizën shqiptare dhe Komisionin e Venecias. Nisma ende nuk është konsumuar dhe debatet brenda opozitës e zhvendosën vëmendjen ndaj saj, ndërkohë që në memorien parlamentare akte të tilla do të duhet të kishin trajtim shumë më serioz dhe më institucional.

## 3.3 GJK, RRËZOI VENDIMIN E KUVENDIT PËR SHKARKIMIN E PRESIDENTIT

Legjislatura aktuale nuk ka ndërmarrë nismë për shkarkimin e Presidentit, por shumë prej deputetëve të saj dhe vetë mazhoranca e ndërmorën këtë nismë gjatë vitit 2021. Në shkurt 2022 doli vendimi i Gjykatës Kushtetuese lidhur me këtë nismë parlamentare.

Sipas vendimit, Gjykata Kushtetuese "vendosi shfuqizimin e vendimit të Parlamentit: "Për shkarkimin e Presidentit të Republikës së Shqipërisë për shkelje të rënda të Kushtetutës." Sipas saj kreu i shtetit nuk ka kryer shkelje të rënda të Kushtetutës. GJK hodhi poshtë edhe pretendimet e mazhorancës socialiste "për shkelje të rënda të Kushtetutës" nga Presidenti Meta. "Faktet e paraqitura për mesazhe përçarëse, marrje të anës së opozitës gjatë fushatës elektorale për zgjedhjet parlamentare të 25 prillit të vitit të kaluar, për shkelje të rendit dhe

[2] Shiko opinionin e plotë të ISP këtu http://isp.com.al/isp-opinion-mbi-projektligjin-mbi-ndryshimet-kushtetuese/?fbclid=IëAR3KYHmU9q6MdyFqËqc5BdËxhq5K7HYiBVm6s8SdpR2_p-UvPEruOkmh-IE

[3] Vetingu i politikanëve, ISP: Bëhet pa ndryshuar Kushtetutën, drafti i PD i paqëndrueshëm, A2 CNN, 7 shkurt 2022. https://a2news.com/video/vetingu-i-politikaneve-isp-behet-pa-ndryshuar-kushtetuten-drafti-i-pd-i-paqendrueshem/?fbclid=IëAR2F-mPnLLZMÇXvUbign1G5S3dkOZQxp5MseUvjUf_yId7jfmKIuOx27RJY

sigurisë publike, të betimit si kryetar shteti për të përfaqësuar unitetin e popullit, për cenim të marrëdhënieve me partnerët strategjikë të Shqipërisë, për shkelje të pavarësisë së organeve publike, të rendit dhe sigurisë publike nuk përbëjnë shkelje të Kushtetutës", theksohet në njoftimin e GJK[4].

Vendimi i GJK do të duhej të shoqërohej me reflektim në sjelljen e iniciuesve të shkarkimit, por parlamenti nuk e mori në shqyrtim vendimin dhe asnjë prej grupeve e deputetëve iniciues nuk pranoi përgjegjësi dhe as nuk sugjeroi hapa institucionale në përmirësimin e praktikave të njëjta parlamentare.

## 3.4 KOMISIONET E POSAÇME, PROGRES MINIMAL

Megjithëse të një rëndësie të veçantë për qytetarët dhe jetën parlamentare, reforma zgjedhore dhe reforma administrative - territoriale nuk morën vëmendjen e duhur nga deputetët në debatin dhe aktivitetin parlamentar. Komisioni i Posaçëm i reformës zgjedhore u jetësua me shumë vonesë dhe gjatë sesionit të fundit është mbledhur vetëm njëherë, pa pasur ndonjë produkt madje as një një plan pune të detajuar.[5] Afati i tij ligjor ka mbaruar pa pasur mbledhje dhe as produkt, në shtator pritet shtyrja e mandatit. Praktika e krijimit të komisioneve të tilla dhe më pas e investimit politik për dështimin e tyre e dobëson instrumentin e komisionit dhe besimin publik tek parlamenti.

Komisioni për Reformën Administrativo-Territoriale vijon funksionin dhe shënoi disa rezultate pozitive sidomos në elementët e konsultimeve dhe seancave dëgjimore me grupe të ndryshme interesi, por ende është larg një vendimmarrjeje finale, ndërkohë që nga Presidentit pritet data e zgjedhjeve të ardhshme lokale. Komisioni krijoi agjendë dhe pati aktivitet publik me më shumë se 10 mbledhje[6], megjithatë mosmarrëveshjet sidomos tek opozita ndikuan në funksionimin e tij.

## 3.5 NJË DEPUTET I BURGOSUR DHE DEBATI MBI KORRUPSIONIN

Në fundin e muajit mars u arrestua deputeti Alqi Bllako (PS), i akuzuar për korrupsion në një prej skandaleve më të mëdha financiare, ku përfshihet edhe ish- deputeti Lefter Koka (PS), gjithashtu i burgosur. Rasti Bllako përbën rastin e parë prej vitesh kur një deputet në funksion arrestohet për korrupsion. Vendin e tij në parlament e zuri pasuesi në listën shumëemërore, Pandeli Majko.

[4] Deutsche Welle: Presidenti Meta nuk shkarkohet, GJK rrëzon vendimin https://www.dw.com/sq/tiran%C3%AB-presidenti-meta-nuk-shkarkohet-gjk-rr%C3%ABzon-vendimin/a-60809134

[5] Shiko, Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore https://www.parlament.al/Struktura?kategori=5&strukture=3074

[6] Shiko https://www.parlament.al/Struktura?kategori=5&strukture=3073

SPAK ka deklaruar disa herë se është duke hetuar disa dosje të tjera, ndërkohë që një proces paralel në Gjykatën e Lartë ka në fokus gjithashtu një deputet. Në total janë rreth pesë deputetë në procese hetimore, nga tri partitë kryesore politike. Në praktikën shqiptare hetimet marrin kohë dhe proceset kanë ngarkesa të mëdha politike, por raste të tilla janë tregues të faktit se një numër deputetësh janë përfshirë në akte korruptive në funksionet e tyre të mëparshme në qeveritë e majta dhe të djathta, dhe se drejtësia "e re" ka nisur të funksionojë edhe për individët me pushtet.

## 3.6 OPOZITA NË PARLAMENT? E PAQARTË DHE PROBLEMATIKE NË PËRFAQËSIM

Debati rreth legjitimitetit të grupit më të madh parlamentar në opozitë vijoi edhe këtë sesion parlamentar. Rreth 15 deputetë mbështetës të ish-kryeministrit Berisha pretendojnë se përfaqësojnë opozitën, një pjesë dy herë më e madhe deputetësh pretendojnë se janë opozita zyrtare, disa deputetë të tjerë nuk kanë qëndrime të qarta. Për pasojë, opozita mbeti nocion i papërcaktuar në aktivitetin parlamentar, rivaliteti mes grupeve më shumë e dobësoi, sesa e forcoi rolin e saj dhe se impakti i debatit mbi legjitimitetin dobësoi edhe strukturat vendimmarrëse parlamentare ku përfaqësohet opozita. Për shembull, kjo ishte një prej arsyeve të vonesës së ngritjes së komisionit të posacëm të reformës zgjedhore, një motiv për kontestime të vendimmarrjeve në Byronë e Kuvendit dhe Konferencën e Kryetarëve dhe një argument që u përdor për të delegjitimuar nisma parlamentare ose akte vendimmarrëse, përfshirë votimin për Presidentin, për disa rezoluta ose nisma ligjore.

Nga ana tjetër, Kuvendi nuk ka arritur ende të krijojë një mekanizëm verifikimi të përkatësisë administrative të opozitës, sistemi i deklarimeve në fillimet e sesioneve nuk është funksional, lëvizjet e deputetëve nuk janë të dokumentuara, sponsorizim i grupeve bazohet në interesat politike të mazhorancës dhe kjo e fundit, përfitoi nga kriza e opozitës në dëm të standardeve të mira parlamentare. Për shembull, të gjitha nismat, qëndrimet dhe kërkesat që erdhën nga deputetët mbështetës të njërit prej fraksioneve në PD u refuzuan apriori nga mazhoranca, në shkelje të të drejtave të deputetit dhe të standardeve parlamentare.

## 3.7 "NON GRATA" DHE LISTA E SANKSIONEVE, PARLAMENTI NËN PRESION

Vendimi i qeverisë amerikane për të përfshirë në listën "non grata" një prej politikanëve kryesorë të opozitës, dhe më pas edhe indirekt, përmes sanksioneve edhe dy deputetë të mazhorancës, të cilët përfituan mandat në rrugë abuzive, ndonëse i mirëpritur, dominoi ligjërimin politik në parlament dhe dobësoi standardin e integritetit në përfaqësim.

Opozita nuk arriti dot të ndjekë standarde të larta etike dhe integriteti për zgjidhje afatgjatë pozitive në raste të tilla, vetë protagonistët e keqpërdorën pozitën parlamentare për të promovuar interesat personale politike, ndërkohë që mazhoranca e keqpërdori rastin për të kufizuar dhe censuruar akoma më shumë hapësirën dhe të drejtat e opozitës parlamentare.

Sugjerimi i ISP dhe i shoqërisë civile, që grupet parlamentare në rregullat e brendshme të funksionimit të përcaktojnë standarde etike dhe integriteti, që deputetët e përfshirë të reflektojnë tej interesave të tyre mbi impaktin negativ që sjellin për Kuvendin dhe forcat politike që përfaqësojnë, si dhe që nga struktura vendimmarrëse në Kuvend, përfshirë komisionin e integrimit, të largohen individët që janë direkt ose indirekt pjesë e "listës së zezë", është injoruar si nga mazhoranca ashtu edhe nga opozita. Paradoksalisht, duket se palët më shumë kanë interes të ketë sa më shumë politikanë të sanksionuar (nga pala tjetër politike) për t'i keqpërdorur rastet për alibi e luftë politike, sesa të kërkojnë e gjejnë mjete e mekanizma që sigurojnë një parlament të pastër, pa politikanë të inkriminuar apo pjesë të penalizimeve perëndimore.

- ***Deputeti Bujar Leskaj*** *është i vetmi deputet, i cili përmes një komenti të gjatë në media analizoi raportin e ISP mbi parlamentin dhe procesin e monitorimit të Kuvendit nga shoqëria civile. Krahas vlerësimeve për raportet monitoruese Leskaj ofroi edhe rekomandime, kryesisht lidhur me sistemin e vlerësimit të deputetëve, duke kërkuar më shumë vëmendje për cilësinë e debatit parlamentar.*

- ***Kryetarja e Kuvendit Lindita Nikolla dhe kreu i grupit të PD Enlelejd Alibeaj*** *ishin të vetmit deputetë nga kryesia e Kuvendit, kryetarët e grupeve/partive parlamentare dhe kryetarët e Komisioneve që reaguan ndaj ISP pas adresimit prej nesh të disa rekomandimeve përmirësuese në Rregulloren e Kuvendit dhe legjislacionin mbështetës për komisionet parlamentare dhe ato hetimore.*

- *ISP ishte pjesë e organizatave të shoqërisë civile që mbështetën fuqizimin e parlamentit dhe rolin e tij sidomos në procesin e integrimit. Në dy aktivitete të organizuara me parlamentin ISP gjeti mbështetje me prezencën dhe kontributin pozitiv të deputetëve* ***Jorida Tabaku, Etilda Gjonaj, Ermonela Felaj, Belind Këlliçi, Erisa Xhixho dhe Kreshnik Çollaku****. Disa deputetë të tjerë të ftuar nuk iu përgjigjën pozitivisht ftesave tona.*

## 3.8 FUNKSIONI LIGJVËNËS, STATISTIKA DHE PROBLEMATIKA

Në ushtrimin e funksionit ligjvënës gjatë sesionit janar – korrik 2022 Kuvendi shënoi progres statistikor në raport me sesionin e kaluar, si dhe trajtoi shumicën e nismave ligjvënëse të ardhura nga vetë deputetët. Ashtu si edhe në të kaluarën, Këshilli i Ministrave vijon të ketë monopolin e nismave ligjore dhe shumica absolute e nismave që vijnë nga deputetët opozitarë nuk sigurojnë mbështetjen e shumicës parlamentare. Disa prej nismave të deputetëve lidheshin me kërkesa të grupeve të ndryshme lobuese apo grupeve të interesit, me nisma politike lidhur me çështje të ditës, por pati edhe nisma ligjore që vijnë nga ekspertiza dhe lidhen me problemet sektoriale. Veçojmë propozimet e ardhura në fushën e bujqësisë nga deputeti Agron Duka, të cilat nuk morën dot mbështetjen e mazhorancës vendimmarrëse.

Nga ana tjetër, disa deputetë të mazhorancës e përdorën me pozitivitet dhe efektivitet mandatin parlamentar duke adresuar, kërkuar dhe propozuar akte e politika në shërbim të qytetarëve, zonës elektorale dhe interesit publik. Në dallim nga praktikat e mira parlamentare shumica e këtyre nismave gjithashtu nuk u morën në konsideratë në vendimmarrjen finale të parlamentit, megjithatë ato përbëjnë dhe mbeten një prej kontributeve më të rëndësishme të këtij sesioni parlamentar. Nga mazhoranca merita kryesore i përket deputetit Erion Braçe në fushën ekonomike dhe të bujqësisë, si dhe ndërhyrjeve profesionale të deputetit Fatmir Xhafaj, sidomos në çështjet e drejtësisë.

Në tërësi nismat ligjore kaluan përmes debateve konstruktive në komisione dhe u shoqëruan me relacione dhe informacione nga institucionet iniciuese. Disa pretendime të deputetëve për mungesë informacioni, për mungesë studimesh dhe të dhënash mbi impaktin dhe nevojën e ndërhyrjes apo për ndryshime të agjendës legjislative në funksion të politikës së ditës, duhet të merren më shumë në konsideratë nga Kuvendi. Raportime kritike të medias për nevojën e publikimit të rregullt online të drafteve ligjore, relacioneve, pasqyrave të konsultimit publik dhe votimin e deputetëve gjithashtu meritojnë vëmendje dhe adresim më institucional nga Kuvendi.

## 3.9 KONTROLLI PARLAMENTAR, BILANCI GRI I KUVENDIT

Kuvendi ka rol thelbësor në kontrollin parlamentar ndaj pushtetit ekzekutiv, institucioneve që raportojnë në Kuvend, procesit të mbikëqyrjes post legjislative dhe aktivitetit të vetë strukturave parlamentare. Gjatë sesionit nuk pati mocion besimi dhe as mosbesimi, pasojë e ndryshimeve kushtetuese të vitit 2008, si dhe nuk pati seanca të posaçme pyetjesh adresuar kryeministrit. Në tërësi pati rritje të numrit të interpelancave, por jo të produktit të tyre. Tradita e interpelancave, sipas të cilave deputetët (sidomos opozita) kritikon ashpër një ministër dhe ky i fundit i përgjigjet me devijim nga tematika me akuza e gjuhë kritike ndaj iniciuesit vijoi edhe në

këtë sesion parlamentar. Gjatë sesionit të fundit pati disa raste kur iniciuesit e interpelancave u ndjenë të fyer nga zyrtarët përgjegjës, përfshirë kryeministri ose ministri për parlamentin, si dhe nuk pati raste kur iniciuesit e tyre të shprehnin ndonjë konsideratë pozitive për aktivitetin e ministrisë, të cilës i adresohej ajo. Këto praktika janë dekurajuese për deputetët dhe më shumë shpërdoron, sesa forcon institucionin e interpelancës.

Kuvendi krijoi perceptimin se më shumë vepron në funksion të agjendës së kryeministrit, sesa e kundërta, që qeveria të ndjehet përgjegjëse përpara parlamentit. Komisioni hetimor për inceneratorët mbetet një përjashtim pozitiv, falë edhe sjelljes konstruktive formale edhe të zyrtarëve përgjegjës të thirrur në seancën dëgjimore, përfshirë kryeministrin. Nismat dhe mekanizmat e tjerë kontrollues nuk funksionuan plotësisht ose nuk arritën të bëjnë diferencë pozitive, ndërkohë që qasja bipartizane e palëve dobëson forcën dhe efektivitetin e komisioneve parlamentare, komisioneve hetimore, strukturave llogaridhënëse dhe procesit kontrollues kushtetues.

Në aneksin mbi institucionet që zgjidhen ose raportojnë në Kuvend janë trajtuar më në detaje problematikat e këtij sesioni parlamentar, por në tërësi institucionet e thirrura për raportim nuk u ndjenë nën presionin pozitiv parlamentar për llogaridhënie. Analiza e jetësimit të rezolutave të kaluara dhe propozimet për rezolutat e reja ishin më shumë shprehje e vullnetit politik, sesa akte të kontrollit kushtetues, transparencës dhe llogaridhënies. Disa prej çështjeve me interes të theksuar publik dhe që përbëjnë shqetësim qytetar gjatë viteve 2021 dhe 2022 nuk ishin pjesë e rezolutave, si dhe në tërësi raportimet në seancat plenare në Kuvend ishin formale.

## 3.10 FUNKSIONI ZGJEDHOR I KUVENDIT, MODELE E PROBLEMATIKA

Gjatë këtij sesioni parlamentar Kuvendi do të duhet të ushtronte kompetencën zgjedhore për një numër të madh zyrtarësh të lartë, përfshirë Presidentin e Republikës dhe Avokatin e Popullit. Në rastin e Presidentit praktika u bë formale dhe u njësua me qëndrimin politik të grupit të PS, i cili pas tre raundeve pa kandidat, përzgjodhi kandidatin e vetëm, të cilin edhe e votoi për President.

Në zgjedhjen e Presidentit u konstatuan disa problematika. Së pari, që zgjedhja e Presidentit erdhi përmes një procesi të mbyllur politik brenda grupit të PS. Një nismë për konsultime me shoqërinë civile dështoi, pasi nuk pati seancë të dytë, pavarësisht paralajmërimit se do të kishte konsultime. Së dyti, opozita hoqi vullnetarisht dorë nga e drejta dhe mundësia kushtetuese për të propozuar kandidat për president. Kjo sjellje politike jo konstruktive e dobësoi procesin dhe e nxori opozitën jashtë procesit. E treta, procedura për zgjedhjen e kandidatit për president deri në zgjedhjen e tij u bë brenda një kohe të shkurtër, në fundjavë (zyrtarisht ditë pushimi), me procedura të përshpejtuara, pa një CV dhe rekorde të detajuara

publike lidhur me kandidatin dhe pa informuar publikun për pikëpamjet e tij lidhur me postin e ri. Për shembull, nëse për një anëtar të thjeshtë në bordin drejtues të AIDSSH, BQ apo RTSH kërkohet seancë dëgjimore publike dhe CV e detajuar, për Presidentin nuk kërkohet asnjëra prej tyre, madje as prania e tij në komisionin vendimmarrës.

Avokati i Popullit do të duhej të zgjidhej dy muaj përpara mbylljes së sesionit parlamentar, por Kuvendi dështoi ta bëjë zgjedhjen deri në korrik 2022, duke ia kaluar sesionit të vjeshtës. Jashtë procedurave dhe standardeve të mira parlamentare Komisioni përgjegjës vendosi shtyrjen e afateve për kandidatët, pavarësisht numrit të madh të kandidatëve në garë, duke krijuar përshtypjen e bazuar se komisioni synon të shtyjë procesin deri në imponimin e kandidatit të preferuar për këtë post. Po ashtu Kuvendi ndoqi standarde të dyfishta për kandidatët për AIDSSH, si dhe disa funksione të tjera, megjithëse ISP vlerësoi drejtimin e seancës me kandidatët nga deputeti Ndreca, si një përjashtim pozitiv nga praktika e tensionuar politike e seancave dëgjimore.

# 4. KUVENDI, TRANSPARENCA DHE PROBLEMATIKA

Programi i transparencës, si dhe sistemi i konsultimeve dhe i llogaridhënies janë detyrim ligjor për parlamentin dhe për të gjitha institucionet e tjera shtetërore. Për një vend si Shqipëria standarde të tilla janë edhe pjesë e vlerësimit për nivelin e shtetit të së drejtës dhe të demokracisë funksionale. Në raportet tona monitoruese ISP ka ndjekur nivelet e jetësimit të këtij standradi, duke nxjerrë në pah zhvillimet pozitive dhe problematikat, si dhe duke adresuar rekomandime të vazhdueshme përmirësuese.

## 4.1 TRANSPARENCA: ARRITJE DHE PROBLEMATIKA

Procesi i nisur në fillimet e legjislaturës për një informim më të mirë publik mbi përbërjen, bilancin, statistikat dhe dokumentet parlamentare vijoi edhe në këtë sesion, por me ritëm më të ulët. Në faqen zyrtare të parlamentit nuk ka asnjë dokument të ri informues mbi sesionin dhe mungojnë elementë të rëndësishëm, përfshirë procesverbale, të dhëna mbi dokumentacionin, mbi CV e kandidatëve për poste të ndryshme në Kuvend, të dhëna për kërkesat për informim, për trajtimin financiar apo për aktivitete parlamentare jashtë komisioneve dhe seancave. Për shembull, numri i rasteve kur Kuvendi publikon të dhëna nga aktiviteti i deputetëve dhe delegacioneve parlamentare është minimal, duke u fokusuar kryesisht në aktivitetin ditor protokollar dhe në aktivitetin e drejtuesit të Kuvendit.

Prej shumë muajsh faqja zyrtare e Kuvendit rezulton "në ndërtim", duke nënkuptuar mirëkuptimin për mungesën e elementëve të mundshëm të transparencës. Në fakt koha e gjatë nën konstruksion përbën një shqetësim më vete dhe një tregues se njoftimi përdoret më shumë si alibi për largim nga përgjegjësia, sesa si praktikë administrative. Kuvendi ka pasur dhe ka të gjithë mbështetjen e duhur financiare dhe burimet njerëzore për të jetësuar një faqe të plotë online brenda një periudhë disa javore, ndërkohë që njoftimi "në ndërtim" vijon që nga viti i kaluar.

Pavarësisht kritikave për standardet e informimit dhe transparencës, një monitorim krahasues i ISP dëshmoi se Kuvendi, me gjithë defektet e cituara, vijon të jetë institucion shumë më transparent, sesa institucione të tjera të rëndësishme dhe të krahasueshme, si Këshilli i

Ministrave apo institucioni i Presidentit. Kuvendi ka më shumë të dhëna me interes publik, ndonëse me vonesë ka plotësime të vazhdueshme të zërave, ka përpjekje për përmirësim të punës përmes Institutit Parlamentar dhe asistohet nga disa programe mbështetëse.

Disa nga elementët pozitivë të transparencës së Kuvendit janë publikimet e rregullta të dokumentacionit lidhur me seancat plenare, publikimi i rezultateve të akteve, publikimi i votës së deputetëve, publikimi i relacioneve dhe njoftimet periodike mbi mbledhjet e komisioneve, publikimet online të mbledhjeve të komisioneve, publikimi i database të akteve, publikimi i agjendës disa javore dhe kalendarit, etj. Platforma e konsultimit publik mbetet e kufizuar dhe formale, ashtu si edhe platforma ndërinstitucionale, e krijuar me aq pritshmëri të larta.

Nga ana tjetër, procesi i konsultimeve në tërësi ishte selektiv dhe formal, duke i dhënë vëmendje dhe hapësirë kryesisht zërave që ishin pro nismave ligjore në agjendë dhe duke injoruar zërat kritikë. Kuvendi vetë nuk ka ende një mekanizëm matës të performancës ligjore dhe të procesit konsultues të ligjeve. Platforma e konsultimit publik nuk rezultoi funksionale dhe disa teste edhe nga stafi monitorues i ISP treguan se në tërësi ajo mbetet një praktikë formale që nuk ofron standardet e kërkuara të konsultimit publik dhe nuk e adreson dhe as merr reagim për sugjerimet e dërguara.

## 4.2 GRUPET PARLAMENTARE, MUNGESË TRANSPARENCE DHE LLOGARIDHËNIE

Asnjë nga grupet parlamentare nuk ka një faqe të dedikuar aktiviteti, transparence dhe llogaridhënie. Kjo nuk ndodh as në faqen e dedikuar të Kuvendit dhe as në faqet e partive politike, të cilave u përkasin grupet. Në të dhënat online mbi përbërjen e grupeve nuk ka informacion të ri dhe as informacion cilësor, duke i mbetur besnik informacioni statik të fillimit të legjislaturës mbi përbërjen e grupeve. Vetë grupet kanë detyrim ligjor të hartojnë rregullore të brendshme funksionale dhe detyrim etik ta bëjnë publike atë, si dhe detyrim e angazhim politik të bëjnë publike analizën e bilancit të punës në nivel grupi dhe në nivel deputetësh. Asnjëri prej grupeve parlamentare nuk i ka përmbushur ende këto pritshmëri, të cilat janë standarde bashkëkohore në modelet e njëjta në vendet e Bashkimit Europian.

Grupet parlamentare nuk publikojnë as raporte vjetore të punës së tyre, të sistemit të meritës, të analizës në përfaqësim dhe të përputhshmërisë midis programit politik dhe aktivitetit parlamentar. Ato nuk publikojnë as qëndrime kritike ose masa ndaj deputetëve që shkelin etikën ose janë në konflikt interesi, etj, duke krijuar një model negativ për veten dhe për pasojë, edhe për jetën parlamentare në Shqipëri. Perceptimi i përgjithshëm mbetet ai sipas të cilit, grupet parlamentare funksionojnë si trupa zbatuese të vendimeve të drejtuesve të grupit, dhe se duke qenë pa standarde transparence e llogaridhënie ato e kanë të pamundur të ofrojnë standarde të tilla për parlamentin në tërësi dhe jetën politike në përgjithësi.

## 4.3 KOMISIONET PARLAMENTARE, BILANCI DHE PROBLEMATIKA

Aktiviteti më i ngjeshur parlamentar është puna në komisione. Zhvillimi i mbledhjeve online ka rritur aksesin publik për komisionet, praktikat e seancave dëgjimore apo e konsultave publike kanë ndikuar gjithashtu pozitivisht. Performanca e komisioneve në tërësi është rritur, ka më pak incidente në mbledhje, ka më pak raste bojkoti dhe ka shumë angazhim të drejtuesve të komisioneve për të respektuar agjendën dhe për të krijuar një mjedis inkurajues pune. Disa komisione, si ai i ligjeve, i ekonomisë, i veprimtarive prodhuese, etj, mbajnë peshën kryesore të debatit, por gjatë sesionit mori vëmendje të veçantë edhe komisioni për mjetet e informimit, kryesisht për shkak të debatit lidhur me projektin e Butrintit.

Në elementët kritikë të aktivitetit në komisione mund të renditet pasiviteti i disa prej deputetëve më me përvojë parlamentare gjatë debateve ose pjesëmarrjes në komisione, disa incidente të panevojshme dhe të evitueshme midis palëve politike, drejtimi i komisioneve kryesisht me natyrë politike (shumica e kryetarëve të komisioneve nuk respektojnë konceptin e moderimit të debatit, por bëjnë komente politike, sidomos në komisionin e ligjeve, të sigurisë, etj), paraqitja gati formale e zyrtarëve ekzekutivë në komisione, duke mos i kushtuar vëmendjen e duhur kritikave apo sugjerimeve që vijnë nga deputetët, si dhe mungesa e vëmendjes së medias në raportim, për shkak të kufizimeve të pranisë së tyre fizike. Shqetësim vijon edhe praktika e publikimit me vonesë të materialeve të komisioneve, sidomos procesverbalet. Ky është një problem i vjetër teknik që parlamenti do të duhej ti kishte dhënë zgjidhje me kohë. Për shembull, në fundin e muajit gusht kur ky raport po hartohet, ende nuk është publikuar në faqen e parlamentit asnjë procesverbal komisioni për muajin korrik, ndërkohë që në disa komisione mungojnë edhe procesverbalet e muajit qershor 2022.

Në aspektin statistikor duhet theksuar se deputetët më të pranishëm në komisione janë disa deputetë që nuk diskutojnë thuajse asnjëherë në komisione dhe as në seancat plenare, pra shërbejnë aty për të siguruar kuorumin e komisionit dhe për të përfituar trajtimin financiar. Po ashtu nuk kanë marrë pjesë në asnjë komision dhe mbledhje komisioni deputetë të njohur si Berisha, Basha, Kryemadhi, etj, ndërkohë që nga deputetët e PS të gjithë janë të pranishëm në komisione, përfshirë kryetarin e grupit.

Një pjesë e deputetëve, duke qenë njëherësh në më shumë se një komision dhe po ashtu edhe në nënkomisione, kanë qenë të detyruar të jenë pjesërisht prezent, duke mos arritur ta ushtrojnë tek asnjëri angazhim 100% funksionin e tyre. Nevoja për kuorum ka dominuar nevojën për cilësi përfaqësimi në komisione.

Kuvendi ka ngritur edhe disa nënkomisione, një zhvillim ky pozitiv, por ende pa impakt në aktivitetin parlamentar dhe diskursin publik. Disa prej tyre, sidomos ato që kanë lidhje me të

drejtat e njeriut, qeverinë vendore, administratën publike, etj, kanë pasur raste të shumta për të qenë aktivë, sidomos kur çështjet e tyre kanë qenë headline në debatin publik. Ka nënkomisione që janë aktive kryesisht kur në mbështetje të tyre ka donatorë të ndryshëm ndërkombëtar, pra në funksion të projekteve, jo në funksion të një agjende të brendshme të koordinuar dhe publike. Lidhur me transparencën edhe nënkomisionet kanë të njëjtën problematikë.

Organizimi në komisione, nënkomisione, adresimi i çështjeve dhe administrimi parlamentar kanë nevojë të kenë harmoni më të madhe, edhe në aspektin organizativ dhe administrativ. Për shembull, ISP kritikoi rastet kur dy struktura parlamentare të drejtuara nga i njëjti person i shkruajnë njëra - tjetrës (rasti i integrimi) apo kur kryetarja e Kuvendit si inicuese akti i adreson vetes propozimin (rasti i presidentit). Në dy rastet reagimi i Kuvendit ishte refuzues ndaj kritikës, ndërkohë që praktikat e mira parlamentare sugjerojnë sjellje tjetër, përfshirë ndryshimin e praktikës së akteve të brendshme administrative dhe përmirësimin e akteve të brendshme rregullatore.

## 4.4 PJESËMARRJE KRITIKE E DEPUTETËVE NË SEANCAT PLENARE

Sesioni i fundit parlamentar shënoi rekordin e rënies drastike të pjesëmarrjes së deputetëve në debatet parlamentare. Të dhëna të vazhdueshme të ISP dhe të medias dëshmuan raste të shumta kur edhe në debate të rëndësishme politike në parlament nuk ndodheshin më shumë se 8-12 deputetë, shifta më ulët historike në parlamentarizmin shqiptar. Në tërësi folësit nuk munguan dhe nuk hoqën dorë nga diskutimet, por auditori përpara tyre ishte kryesisht pa kolegë që dëgjonin.

Rënia e interesit për prezencë në debate lidhet sa me rënien e rëndësisë së debatit parlamentar dhe cështjeve që diskutohen, mungesën e rregullave detyruese nga grupet dhe parlamenti, ashtu edhe me faktin se transmetimi televiziv & online nuk i jep vëmendje deputetëve të pranishëm, pra e bën të parëndësishme prezencën e tyre. Nga monitorimi i mbledhjeve të Byrosë dhe Konferencës së Kryetarëve nuk pati raste kur drejtuesit e Kuvendit dhe të grupeve ta kenë ngritur si shqetësim këtë fenomen, ndërkohë që në raportimet e medias pati rritje të zërave kritikë dhe apeleve për një sjellje të re më të përgjegjshme të parlamentit në raport me aktivitetin parlamentar.

## 4.5 KONFLIKTI I INTERESIT: DY HAPA PARA, NJË HAP PAS

Kodi i Etikës dhe ligji për konfliktin e interesit kërkon që në rast së në Kuvend paraqitet një projektligj ose akt tjeter parlamentar që krijon konflikti interesi, deputetët të deklarojnë me shkrim pranë Këshillit të Legjislacionit. Në vitet e shkuara është vënë re se qasja e deputetëve

ka qenë problematike ndaj kësaj normative duke mos deklaruar konfliktet e mundshme të interesit. Megjithatë, këtë sesion ka pasur disa zhvillime pozitive. Gjashtë deputetë kanë deklaruar gjendje në konflikt interesi, nga të cilët katër në rastin e ligjit për noterinë, kaluar në Kuvend në janar 2022. Konkretisht deputetët Pëllumbi (PS), Sula (PD), Xhixho (LSI) dhe Zake (PS), të tre për të njëjtin motiv: bashkëshorti/bashkëshortja ushtrojnë detyrën e noterit, pra lidhen direkt me përfitimet që vijnë nga ndryshimi ligjor.[7] Në një rast tjetër konflikti i interesit lidhej me lidhjet familjare me personin që ishte në votim (Metaj, PS), me lidhjet e biznesit (Bushka, PS).

Megjithatë, gjatë këtij sesioni ka pasur pretendime për gjendje të tjera në konflikt interesi që nuk janë deklaruar. Në një rast ISP ndikoi në evitimin e një rasti të konfliktit të interesit në votimin për organet e vetingut, por gjithsesi deputetja Balluku nuk e ka deklaruar në faqen e Kuvendit. Në dy raste të tjera media raportoi lidhur me gjendjen e mundshme në konflikt interesi të dy deputeteve për shkak të vendimmarrjeve të ndërlidhura me biznesin e anëtarit të familjes, etj. Kuvendi nuk pati reagim dhe nuk ka një mekanizëm që provon nëse struktura e posacme në Kuvend i heton raste të tilla, sipas përcaktimeve ligjore.

## 4.6 ETIKA PARLAMENTARE, RASTE SHQETËSUESE DHE STANDARDE TË DYFISHTA

Gjatë sesionit pati raste të shumta të abuzimit me etikën parlamentare, të tilla si rastet e fyerjeve ndaj grave deputete e ministra, rastet e fyerjes personale midis deputetëve, rastet e gjuhës vulgare në foltoren parlamentare apo rastet e përdorimit të shpeshtë të termit "vdekje" për rivalin politik. Gjuhë denigruese dhe fyese apo akte jo etike u shfaqën edhe në komisionet parlamentare, përfshirë në komisionin që mbulon kulturën dhe arsimin. Nga shumica e këtyre rasteve, Kuvendi reagoi institucionalisht në vetëm një rast, dhe në një tjetër imponoi ndjesën publike të deputetit, të dyja nga deputetë të opozitës. Nga ana tjetër Kuvendi nuk reagoi dhe as nuk pati qëndrim të njëjtë korrektues për të gjitha rastet e deputetëve të mazhorancës, përfshirë kryeministrin dhe ministrin për parlamentin.

Pafuqia e Kuvendit për të jetësuar standardet etike lidhet jo vetëm me pafuqinë e strukturës së tij për të pasur sjellje të njëjtë për akte të njëjta pavarësisht palës politike, por edhe nga mungesa e praktikave të mira reflektuese në grupet parlamentare apo edhe fakti se retorikat denigruese vijnë kryesisht nga liderit kryesorë politikë. Imponimi i shkeljeve etike "nga lart" u shfaq shqetësuese në këtë sesion sidomos në rastet kur komente e shkelje të tilla u duartrokitën nga deputetët mbështetës ose u morën në mbrojtje nga kolegët e tyre parlamentarë.

[7] Tre deputetë janë në KONFLIKT INTERESI në Kuvend, ISP konfirmoi një rast të padeklaruar: Grupet parlamentare të nxisin, Neësboomb, 1 shkurt 2022. https://newsbomb.al/tre-deputete-jane-ne-konflikt-interesi-ne-kuvend-isp-konfirmoi-nje-rast-te-padeklaruar-grupet-parlamentare-te-nxisin/?fbclid=IëAR3eeZu2anH1yoë0CoË_4R2gvHeuIayPd6fgMh-VHËËMi8GjSAëHy6tZQamE

Në aspektin formal media vijoi të kishte pritje jo etike sidomos ndaj grave deputete në pothuajse të gjitha seancat parlamentare, duke u fokusuar në veshjen dhe paraqitjen e tyre, si dhe në tërësi media nuk arriti të ketë një qëndrim profesional distancues nga retorikat denigruese parlamentare të deputetëve, duke u dhënë atyre hapësirë të dedikuar dhe vëmendje maksimale publike.

## 4.7 BURIMET MBËSHTETËSE PARLAMENTARE

Në media ka pasur vazhdimisht lajme kritike për kostot financiare të aktivitetit parlamentar, duke u fokusuar kryesisht tek shifrat e rrogave dhe dietave dhe tek deputetët jo aktivë në parlament. Kritika të tilla janë të zakonshme edhe në vende të tjera, gjithsesi nga Kuvendi nuk ka pasur sqarime publike dhe informim të publikut për mënyrën sesi funksionon parlamenti.

Ekspertët monitorues të ISP vlerësojnë se në tërësi mbështetja financiare për deputetët është normale, madje në aspektin asistues është shumë më e vogël sesa do të duhej. Deputetët nuk kanë mjedise pune në zonat elektorale, nuk kanë stafe mbështetëse, nuk kanë mundësi për të kontraktuar ekspertë për aktivitetin e tyre ligjvënës, etj. Nga ana tjetër, nevoja për të pasur më shumë transparencë dhe verifikime të të dhënave, sidomos lidhur me deputetët që përfitojnë shifra të larta trajtimi financiar ndërkohë që kanë banesa paralele në Tiranë, përbën një kritikë të përhershme për Kuvendin.

## 4.8 NGRITJA E KAPACITETEVE TË KUVENDIT DHE DEPUTETËVE

Kuvendi ka krijuar prej fillimit të legjislaturës Institutin Parlamentar sipas modelit të parlamentit në Maqedoninë e Veriut. Instituti nuk është plotësuar ende me strukturë dhe praktikat rekrutuese shfaqin vështirësi e problematika, gjithsesi ai mbetet një zhvillim pozitiv dhe me rëndësi në rritjen e kapaciteteve të parlamentit dhe në kontekst më të gjerë, edhe për deputetët e interesuar. Njëkohësisht Kuvendi ka zhvilluar disa aktivitete trajtuese dhe promovuese të praktikave të mira parlamentare, kryesisht në fushën e çështjeve gjinore, të integrimit, të drejtave të njeriut, të promovimit të deputetëve të rinj, si dhe vijon të ketë botime periodike përfshirë revistën "Kuvendi". Suksesi i tyre ndërvaret nga pjesëmarrja e deputetëve, nga kontributi i tyre me përvoja, njohuri dhe studime, por edhe nga përputhshmëria e nevojave me asistencën e ofruar.

Sfida e rritjes së kapaciteteve mbetet thelbësore për Kuvendin në fazën e re kur Shqipëria ka nisur procesin e bisedimeve për anëtarësim në BE. Kuvendi ka rol thelbësor në këtë drejtim, dhe deputetët, partitë, grupet, por edhe pjesa administrative parlamentare, do të duhet të kenë trajtimin e duhur, njohuritë e thelluara dhe aftësinë të përballen me sfidat e reja.

# 5. KLASIFIKIMI I EFIKASITETIT TË DEPUTETËVE
## (JANAR – KORRIK 2022)

ISP vijon të monitorojë performancën e deputetëve. Gjatë këtij sesioni ISP bëri përpjekje për të sjellë një risi në raport me monitorimin, duke monitoruar në detaje brendësinë e fjalimeve dhe ndërhyrjeve të deputeteve në seancat plenare, për të bërë diferencën midis fjalimeve konsumatore e protokollare, me fjalimet me përmbajtje parlamentare. Monitoruesit e ISP kanë pasur vazhdimisht sugjerime nga deputetët për ta bërë këtë vrojtim të thelluar. Të dhënat e këtij aspekti monitorues janë me interes publik sepse tregon se disa prej deputetëve më aktivë në diskutimet parlamentare konsumojnë më shumë retorikë politike ditore, sesa kanë përmbajtje parlamentare, siç mund të jenë, diskutime për ligje dhe problematika legjislative, propozime për ndërhyrje përmirësuese, diskutime për sfidat e parlamentit dhe detyrat e deputetëve, diskutime për përfaqësimin politik dhe raportet deputet – zgjedhës, etj.

Ky raport paraqet klasifikimin e radhës për nivelin e efikasitetit të deputetëve në të gjithë komponentët e aktivitetit të tyre, përfshirë risinë e mësipërme.

### 5.1 DEPUTETËT MË EFIKASË: TABAKU (PD) DHE BRAÇE (PS)

Njësoj si në sesionin e kaluar parlamentar dy deputetët me nivelin më të lartë të angazhimit / efektivitetit parlamentar u rikonfirmuan Jorida Tabaku (PD) dhe Erion Braçe (PS). Tabaku ka më shumë angazhime në debatet parlamentare dhe drejtoi komisionin kryesor hetimor, Braçe ka nivel të lartë angazhimi në aktivitetet parlamentare në tërësi. Po ashtu, nga deputetët e tjerë më cilësorë ruhet gati i njëjti vlerësim me dallime të vogla në renditje. Bujar Leskaj (PD), Ina Zhupa (PD), Petrit Vasili (LSI), dy drejtuesit e grupeve parlamentare Balla e Alibeaj, etj, janë ndër deputetët me nivelin më të lartë të angazhimit parlamentar.

Në listën e 20 deputetëve më aktivë bëjnë pjesë edhe kryetarët e komisioneve Pëllumbi, Bushka, Shalsi, etj, si dhe deputetët që kanë drejtuar përkohësisht komisione si Koçi, Çupi, etj. Nga deputetët pa rol drejtues, por aktivë në parlament, konfirmohet Koliqi (PD), Xhixho (LSI), Shehi (LZHK), Duma dhe Sula (PD), etj.

# LISTA E 20 DEPUTETËVE MË EFEKTIVË 2022

| | EMRI DHE MBIEMRI | GRUPI | 100 PIKE |
|---|---|---|---|
| 1 | JORIDA TABAKU | PD | 75.9 |
| 2 | ERION BRAÇE | PS | 75.7 |
| 3 | BUJAR LESKAJ | PD | 70.5 |
| 4 | INA ZHUPA | PD | 70.4 |
| 5 | PETRIT VASILI | LSI | 70.1 |
| 6 | ENKELEJD ALIBEAJ | PD | 63.6 |
| 7 | TAULANT BALLA | PS | 60.3 |
| 8 | ARBEN PËLLUMBI | PS | 52.6 |
| 9 | PETRO KOÇI | PS | 51.0 |
| 10 | KLOTILDA BUSHKA | PS | 50.5 |
| 11 | EMILJA KOLIQI | PD | 50.3 |
| 12 | DASHAMIR SHEHI | LZHK | 50.0 |
| 13 | DASHNOR SULA | PD | 49.4 |
| 14 | TRITAN SHEHU | PD | 49.3 |
| 15 | DHURATA ÇUPI | PD | 49.0 |
| 16 | EDUARD SHALSI | PS | 48.1 |
| 17 | ANTONETA DHIMA | PS | 47.7 |
| 18 | FERDINANT XHAFERAJ | PD | 47.3 |
| 19 | GRIDA DUMA | PD | 47.1 |
| 20 | ERISA XHIXHO | LSI | 44.8 |

## 5.2 DEPUTETËT MË PAK EFIKASË 2022

Në listën e deputetëve më pak të kuotuar, pra edhe me treguesit më minimalë të angazhimit dhe të efikasitetit në sesionin e parë parlamentar të legjislaturës së re, me ndonjë përjashtim bëjnë pjesë të njëjtit emra që kanë qenë edhe në renditjet e mëparshme kritike.

Ka edhe politikanë të njohur, kryesisht nga opozita, të cilët kanë pasur nivel minimal angazhimi parlamentar, ndoshta nga synimi i tyre për të qëndruar të tërhequr nga zhvillimet politike, për shkak të klimës së tensionuar brenda saj ose dhe vështirësive për të përballuar presionin ose pendimin për hyrjen në politikë.

Nga ana tjetër deputetët e PSD figurojnë në bllok si deputetë jo efektivë për shkak se nuk kanë lënë gjurmë parlamentare. Fakti se PSD, partia surprizë e zgjedhjeve parlamentare 2021 ka edhe nivelin më të ulët të përfaqësimit dhe efektivitetit në parlament, është një tjetër tregues i natyrës klienteliste dhe aksidentit historik në përfaqësim.

LISTA E DEPUTETËVE ME NIVEL MINIMAL ANGAZHIMI PARLAMENTAR 2022

| EMRI DHE MBIEMRI | GRUPI | 100 PIKE |
|---|---|---|
| AGRON ÇELA | LSI | 3.06 |
| ALFRED RUSHAJ | PD | 7.8 |
| EDI PALOKA | PD | 11.8 |
| GLEDIS ÇELIKU | PSD | 13.6 |
| RRAHMAN RRAJA | PS | 14.3 |
| PAULIN STERKAJ | PS | 16.0 |
| MERI MARKIÇI | PSD | 18.3 |
| ELDA HOTI | PD | 18.4 |
| GERTJAN DEDA | PSD | 18.8 |
| LUAN DUZHA | PS | 19.0 |
| FATION VEIZAJ | PD | 20.6 |
| ORNALDO RAKIPI | PS | 20.7 |
| SAIMIR HASALLA | PS | 21.4 |
| KASËM MAHMUTAJ | PD | 21.8 |

## 5.3 DEPUTETËT ME MË SHUMË FJALIME VS ATA ME "0" FJALIME

Tabela paraqet listën e 21 deputetëve më me shumë fjalime në parlament dhe të 17 deputetëve që nuk kanë mbajtur asnjë fjalim në parlament gjatë sesionit janar – korrik 2022. Në listën e parë të deputetëve më oratorët dhe aktivë në diskutimet parlamentare kryesojnë Vasili (LSI), ndjekur nga Zhupa e Leskaj (PD) dhe Balla (PS). Në tërësi në krye të listës janë deputetët e opozitës, të cilët si individë kanë qenë shumë më tepër aktivë në fjalime, ndërkohë që si grup ka numër mesatarisht më të vogël sesa shumica socialiste. Kryeministri Edi Rama ka pasur në total vetëm 7 fjalime, ndërkohë që ministrat më të pranishëm me fjalime kanë qenë Spiropali dhe Ahmetaj, përkatësisht me dyfishin e fjalimeve të kryeministrit.

### DEPUTETËT ME MË SHUMË FJALIME VS ATA ME "0" FJALIME

| EMRI DHE MBIEMRI | PARTIA | NUMRI | EMRI DHE MBIEMRI | PARTIA | NUMRI |
|---|---|---|---|---|---|
| PETRIT VASILI | LSI | 25 | AGRON ÇELA | LSI | 0 |
| INA ZHUPA | PD | 24 | ALFRED RUSHAJ | PD | 0 |
| TAULANT BALLA | PS | 24 | BENET BECI | PS | 0 |
| BUJAR LESKAJ | PD | 23 | BUJAR ÇELA | PS | 0 |
| SALI BERISHA | PG/PD | 22 | EDI PALOKA | PD | 0 |
| TRITAN SHEHU | PD | 22 | GERTA DURAKU | PS | 0 |
| JORIDA TABAKU | PD | 18 | GERTJAN DEDA | PSD | 0 |
| ANTONETA DHIMA | PS | 17 | GLEDIS ÇELIKU | PSD | 0 |
| DASHNOR SULA | PD | 16 | ILIR TOPI | PS | 0 |
| EDMOND SPAHO | PD | 15 | KASËM MAHMUTAJ | PD | 0 |
| ENKELEJD ALIBEAJ | PD | 14 | LUAN DUZHA | PS | 0 |
| KLOTILDA BUSHKA | PS | 14 | MERI MARKIÇI | PSD | 0 |
| LUAN BAÇI | PD | 14 | NIKO KURI | PS | 0 |
| DASHAMIR SHEHI | LZH6K | 13 | PAULIN STERKAJ | PS | 0 |
| DHURATA ÇUPI | PD | 13 | RRAHMAN RRAJA | PS | 0 |
| ERION BRAÇE | PS | 13 | SELADIN JAKUPLLARI | PD | 0 |
| GRIDA DUMA | PD | 13 | TATIANA PIRO | PS | 0 |
| KRESHNIK ÇOLLAKU | PD | 13 | | | |
| PETRO KOÇI | PS | 13 | | | |

Në listën e deputetëve pa fjalime parlamentare figurojnë në tërësi të njëjtit deputetë si në sesionin e kaluar parlamentar, madje ka deputetë që ndodhen në këtë listë prej dy legjislaturash parlamentare. Mbetet rasti studimor dhe interesant për të parë se si disa deputetë mbijetojnë në secilën zgjedhje dhe vijojnë të rizgjidhen ndërkohë që nuk kanë gjurmë të aktivitetit parlamentar, nuk ndërmarrin nisma ligjore dhe as flasin në debatet parlamentare në seanca ose në komisione. Në listën negative bëjnë pjesë edhe disa figura politike, të cilët mund të kenë qenë aktiv në media ose në komisione, por jo në seancat plenare.

## 5.4 SHUMICA E MINISTRAVE MË SHUMË FJALIME SE KRYEMINISTRI

Nga të dhënat e angazhimit të ministrave në debatet parlamentare vlen të theksohet hendeku i madh i angazhimit midis disa ministrave: kryeministri Rama dhe ministrat Xhaçka e Bilali kanë nga 7 fjalime parlamentare, nderkohë që katër ministra kanë dyfishin më shumë. Rekord mbajnë zv/kryeministri Ahmetaj dhe ministrja Spiropali me nga 16 fjalime, ndjekur nga Balluku dhe Manja me nga 14 fjalime, Manasterliu 13, Ikonomi 12, Kushi dhe Peleshi me nga 11 fjalime. Nëse sektorët e ministrave lart janë prioritete në debat publike (ekonomia, enegjitika, shëndetësia, arsimi dhe drejtësia), rasti i ministres për parlamentin lidhet më shumë me rol e angazhimin politik, sesa me kontributin mbi çështje të reformave dhe procesit ligjvënës.

Vlen të theksohet se anëtari i qeverisë me më shumë fjalime në sesionin janar – korrik 2022 e ka humbur tashmë postin e tij, për shkak se në fundin e muajit korrik Ahmetaj u zëvendësua nga Balluku. Ndryshimet në kabinet erdhën menjëherë pas marrjes së detyrës nga Presidenti i ri dhe u motivuan me vendimin e BE për hapjen e bisedimeve për anëtarësim me Shqipërinë.

Sipas rregullores, kryeministri ka të drejtë pa kufizime për kohën parlamentare për fjalime, duke i dhënë të njëjtin akses kohor edhe liderit të opozitës, por në kushtet kur opozita nuk ka lider në parlament dhe nuk ka unitet për përfaqësim, hapësira e dhënë për kryeministrin ka qenë disproporcionale dhe interesi i tij për fjalime ka qenë kryesisht vetëm për çështje që lidhen me akuza direkte ndaj tij ose për çështje që nxjerrin në pah protagonizmin e tij politik.

# 6. RAPORT I MONITORIMIT TË MARRËDHËNIES SË INSTITUCIONEVE KRYESORE KUSHTETUESE DHE TË PAVARURA ME KUVENDIN

Përpos rolit thelbësor, si organi që mishëron pushtetin legjislativ në Republikën e Shqipërisë, Kuvendi ushtron edhe funksione të tjera shumë të rëndësishme nga pikëpamja kushtetuese, të tilla si kontrolli i institucioneve kryesore kushtetuese dhe të pavarura të ngritura me ligj.

Për të evidentuar më së miri këtë marrëdhënie mes Kuvendit dhe institucioneve, bazuar në nenin 103 të Rregullores së Kuvendit, të ndryshuar, organet kushtetuese dhe ato të krijuara me ligj, kanë detyrimin e raportimit vjetor pranë Kuvendit. Kjo realizohet përmes depozitimit të raportit në Kuvend nga institucionet dhe organizimit të seancës dëgjimore në komisionin përgjegjës për shqyrtim.

Ky detyrim i Rregullores së Kuvendit është caktuar edhe si masë konkrete që duhet zbatuar në vijim nga Kuvendi, si pjesë e detyrave të vendosura edhe në "Manualin për raportimin vjetor dhe periodik të institucioneve të pavarura", të miratuar me Vendimin nr. 134/2018 të Kuvendit të Shqipërisë. Në fund të këtij procesi raportues, Kuvendi miraton një rezolutë për çdo institucion të tillë, duke caktuar rekomandime konkrete për vitin pasardhës, në ato fusha që mendohet se është e nevojshme.

Monitorimi i Kuvendit dhe i veprimtarisë parlamentare në raport me këto institucione, nevojat e këtyre të fundit dhe rezultatet e arritura prej tyre përgjatë çdo viti, është një kontribut për forcimin e shtetit ligjor dhe për një demokraci funksionale. Sikurse e përmendëm edhe më sipër, një proces i tillë ndodh çdo vit dhe periudha e raportimit për realizimin e rezolutave për vitin 2021 është drejt përfundimit.

Sjellim në vëmendje se raportet për këtë vit janë depozituar nga institucionet përgjatë muajve janar-maj dhe të gjithë kanë raportuar tashmë edhe verbalisht përpara komisioneve përkatëse dhe për pothuajse të gjithë institucionet është miratuar një rezolutë nga Kuvendi lidhur me përmbushjen e detyrave dhe rekomandimeve të dhëna gjatë vitit që lamë pas, si dhe me detyrat e reja dhe rekomandimet për vitin 2022.

Vlen të theksohet se deri më datë 27.07.2022 janë miratuar 25 (njëzetë e pesë) rezoluta nga Kuvendi për pothuajse të gjitha institucionet, e më konkretisht për sa vijon:

1. Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP);
2. Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare (AMF);
3. Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA);
4. Agjencia e Sigurimit të Depozitave (ASD);
5. Autoriteti i Konkurrencës;
6. Banka e Shqipërisë;
7. Enti Rregullator i Energjisë (ERE);
8. Enti Rregullator i Ujrave (ERU);
9. Instituti i Statistikave (INSTAT);
10. Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit;
11. Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil (KMSHC);
12. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
13. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD);
14. Departamenti i Administratës Publike (DAP);
15. Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH);
16. Komisioni i Prokurimit Publik (KPP);
17. Avokati i Popullit;
18. Autoriteti për të Drejtën e Informimit mbi Dokumentet e ish Sigurimit të Shtetit;
19. Inspektori i Lartë i Drejtësisë (ILD);
20. Inspektoriati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI);
21. Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ);
22. Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP);
23. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ);
24. Prokurori i Përgjithshëm;
25. Prokuroria e Posaçme Anti Korrupsion (SPAK).

Nga ana tjetër, rezulton se për 1 (një) institucion nuk është miratuar ende rezoluta përkatëse, e më konkretisht për Këshillin Drejtues të Radio Televizionit Shqiptar.

Pavarësisht këtij fakti, sikurse e theksuam edhe më sipër, vlen të përmendet se ky institucion ka depozituar tashmë në Kuvend raportin, ka raportuar në komisionin përkatës lidhur me përmbushjen e rezolutës së vitit paraardhës dhe është miratuar madje edhe projekt-rezoluta për këtë vit. Tani pritet vetëm të vijohet më tej me ecurinë e procedurave për miratimin nga Kuvendi të rezolutës për vitin 2022.

## 6.1 GJETJET REFERUAR INSTITUCIONEVE PËR TË CILAT ËSHTË MIRATUAR REZOLUTË

Referuar 25 rezolutave të miratuara deri tani, rezulton se nga këto institucione afërsisht 40% e tyre i kanë përmbushur plotësisht rekomandimet e dhëna nga Kuvendi për vitin 2021 përmes Rezolutës së vitit të shkuar, ndërsa 44% e tyre rezulton se i kanë përmbushur pothuajse plotësisht. Ndërkaq, pothuajse 16% e tyre rezulton se i kanë përmbushur pjesërisht rekomandimet e Rezolutës së vitit të shkuar nga Kuvendi.

Të dhënat e mësipërme, lidhur me përmbushjen e rezolutave të vitit të shkuar, janë paraqitur grafikisht në figurën 1 më poshtë.

Më në detaje, vlen të thuhet se Banka e Shqipërisë rezulton se ka plotësuar të gjitha rekomandimet e dhëna nga Kuvendi me rezolutën e vitit të shkuar. Lidhur me këtë institucion, përmendim gjithashtu faktin se Guvernatori u rizgjodh në këtë pozicion nga Kuvendi i Shqipërisë në datën 24 shkurt 2022, bazuar në Dekretin e Presidentit të Republikës së Shqipërisë, pra rreth 25 ditë pasi i kishte mbaruar mandati.

E njëjta situatë, për përmbushjen e rekomandimeve të rezolutës së dhënë nga Kuvendi, paraqitet edhe me Entin Rregullator të Energjisë dhe Departamentin e Administratës Publike. Edhe Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi rezulton se kanë përmbushur plotësisht detyrat e rekomandimet e lëna nga Kuvendi, referuar konkluzioneve të rezolutave dhe raportimeve të institucioneve. Gjithashtu edhe ILDKPI, KLGJ, KQZ e SPAK rezulton se i kanë përmbushur plotësisht rekomandimet e dhëna nga Kuvendi përmes rezolutës së vitit të shkuar.

Ndërkaq, rezulton se Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare ka përmbushur 14 nga rekomandimet dhe detyrat e lëna me rezolutën e vitit të shkuar nga Kuvendi, si dhe ka ende 2 detyra në proces përmbushje. Sa i përket Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare, ky i fundit rezulton se ka përmbushur 7 rekomandime dhe ka ende 1 të paplotësuar.

E ngjashme paraqitet situata edhe me Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit, i cili rezulton se ka plotësuar 7 rekomandime, ndërsa 1 është ende në proces përmbushje. Edhe Komisioni i Prokurimit Publik ka përmbushur 5 rekomandime dhe 1 është ende në proces.

Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare rezulton se ka përmbushur 7 nga rekomandimet e Kuvendit të lëna me rezolutën e vitit të shkuar për institucionin, ka 1 ende në proces përmbushje, si dhe 2 të paplotësuara. Ndërsa Enti Rregullator i Ujrave rezulton se ka përmbushur 12 rekomandime dhe ka 1 të paplotësuar. Gjithashtu, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka plotësuar 4 rekomandime, ka 2 në proces përmbushje dhe ka ende 1 pa plotësuar.

Nga ana tjetër, Autoriteti për të Drejtën e Informimit mbi Dokumentet e ish - Sigurimit të Shtetit rezulton se ka përmbushur plotësisht 5 rekomandime, ka përmbushur pjesërisht 1 dhe ka ende në proces 3 të tilla. Ndërkaq, Avokati i Popullit ka përmbushur plotësisht 5 rekomandime dhe ka ende 1 në proces. ILD ka përmbushur plotësisht 4 rekomandime, pjesërisht 1 dhe ka ende në proces përmbushje 3 të tilla. Ndërsa Prokurori i Përgjithshëm ka përmbushur plotësisht 8 rekomandime, pjesërisht 4 të tilla dhe ka ende 1 në proces.

Ndërkaq, Agjencia e Sigurimit të Depozitave ka plotësuar 2 rekomandime dhe ka ende në proces përmbushje 3 të tilla. Autoriteti i Konkurrencës rezulton se ka përmbushur vetëm 3 nga rekomandimet e dhëna nga Kuvendi me rezolutën e vitit të shkuar, ka ende 2 në proces përmbushje, si dhe ka 2 të tjera të paplotësuara. Instituti i Statistikave rezulton se ka plotësuar 5 rekomandime, ndërsa 4 janë ende në proces përmbushje. Së fundmi, Këshilli i Lartë i Prokurorisë rezulton se ka përmbushur 5 rekomandime, ka ende 2 në proces dhe ka 4 të tilla pa përmbushur.

Lidhur me sa më sipër, vlen të përmendet se arsyet e mospërmbushjes së rekomandimeve nga institucionet janë të ndryshme. Më konkretisht, ato lidhen me situatën e pandemisë botërore

Covid-19 dhe pasojat që shkaktoi ajo në Shqipëri, me faktorë që lidhen me subjekte të tretë, shkaqe të tjera përtej kontrollit apo ndikimit të institucionit, si dhe me arsye financiare apo mungesë burimesh njerëzore për të cilat shpeshherë kërkohet edhe mbështetje nga Kuvendi.

## 6.2 KËRKESAT DREJTUAR KUVENDIT

Sa i përket kërkesave drejtuar Kuvendit nga institucionet, si dhe marrjes së tyre në konsideratë nga Kuvendi, vlen të theksohet se nga institucionet për të cilat është miratuar tashmë një rezolutë, rezulton se vetëm 9 prej tyre i kanë drejtuar kërkesa Kuvendit, e më konkretisht Autoriteti i Konkurrencës, Enti Rregullator i Ujit, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Autoriteti për të Drejtën e Informimit mbi Dokumentet e ish - Sigurimit të Shtetit, KLGJ, ILD, Avokati i Popullit, si dhe Komisioni i Prokurimit Publik.

Në raportin e depozituar në Kuvend, Autoriteti për të Drejtën e Informimit mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit i ka bërë me dije Kuvendit, se Autoriteti ka mungesë në strukturën/organikën e vet të punonjësve të cilët duhet të angazhohen lidhur me vënien në vend të dinjitetit njerëzor të personave që vuajtën regjimin totalitar. Për arritjen e këtij qëllimi dhe përmbushjen e përshtatshme të këtij rekomandimi, Autoriteti ka kërkuar nga Komisioni i Ligjeve, që të përfitojë personel shtesë dhe rritje të organikës së tij.

Lidhur me këtë institucion, vlen të përmendet gjithashtu, se më datë 09.06.2022 Kuvendi zgjodhi me shumicë votash bordin e ri drejtues të Autoritetit mes kandidatëve të vetëofruar, atyre të propozuar nga shoqatat e ish të përndjekurve dhe të drejtave të njeriut dhe një propozim të kryeministrit.

Balancimi politik i këtij institucioni të pavarur është 3 me 2 në favor të mazhorancës, duke u bazuar në përkatësinë partiake të deputetëve që kanë firmosur për kandidaturat e anetarëve të rinj. Mandati i Bordit të AIDSSH-së kishte përfunduar që në muajin nëntor dhe pothuaj gjatë gjithë mandatit të parë kishte funksionuar në mungesë të një anëtari pas dorëheqjes së njërit anëtar në vitin 2018. Ndërkaq, po më 09.06.2022 është votuar nga Kuvendi për mandatin e dytë edhe drejtoresha e Autoritetit. Mandati i saj kishte përfunduar që në nëntor të 2021.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në raportimin e tij ka kërkuar mbështetjen e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë në lidhje me mbështetjen financiare, për zbatimin konkret të Hartës së Re Gjyqësore, përmes investimeve infrastrukturore për gjykatat në nevojë, si p.sh. Gjykata e Lartë, Gjykata e Tiranës, etj., rritjes së burimeve njerëzore me numrin e nevojshëm të punonjësve, në përputhje me raportin e fizibilitetit për zbatimin të hartës së re gjyqësore, si dhe lidhur me dizenjimin dhe krijimin e sistemeve bashkëkohore të teknologjisë së informacionit për sistemin e drejtësisë. Sikurse e përmendëm edhe më sipër, ky institucion ka përfshirë në raportimin e

tij vjetor edhe realizimin e disa rekomandimeve të ardhura nga përfaqësues të shoqërisë civile apo organizatave jofitimprurëse në drejtim të përmirësimit të veprimtarisë së tij.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka raportuar se ka vijuar punën me një inspektor të vetëm deri në shkurt të vitit 2021 dhe në vijimësi ka kërkuar komandimin e magjistratëve të tjerë pranë këshillave, e më konkretisht KLGJ dhe KLP, duke shtuar se deri më tani janë emëruar 8 nga 26 inspektorë që parashikon ligji, e duke parashtruar kësisoj nevojën për rishikimin e kuadrit ligjor për sa i përket rishikimit të kritereve për inspektor nga radhët e magjistratëve.

Sa i përket Avokatit të Popullit, theksojmë fillimisht se mandati i ka mbaruar që në muajin maj 2022. Ndërkaq, Kuvendi ka nisur procedurat për zgjedhjen e tij që në muajin mars 2022 dhe ndërkohë ende po vijon procedurat për këtë qëllim. Më konkretisht, në muajin maj 2022 u shty afati i aplikimeve deri në qershor për këtë pozicion dhe së fundmi, në muajin korrik 2022, Kuvendi ka vendosur sërish të shtyjë procedurën për përzgjedhjen e Avokatit të Popullit për në muajin shtator 2022.

Gjatë raportimit në Kuvend, Avokati i Popullit ka ngritur si shqetësim mungesën e bashkëpunimit të administratës shtetërore, sidomos pushtetit lokal me institucionin e Avokatit të Popullit në lidhje me dhënien e informacionit që të kryhet hetim i plotë brenda afateve ligjore për të siguruar besimin e publikut tek institucioni. Në këtë drejtim, nga ana e përfaqësuesve të Kuvendit në Komision është rekomanduar përmes rezolutës, që Avokati i Popullit të informojë Kuvendin për institucionet që nuk kthejnë përgjigje në lidhje me rekomandimet e adresuara si dhe të përfshijë në raportin vjetor dhe periodik institucionet që nuk kanë kthyer përgjigje.

Autoriteti i Konkurrencës ka kërkuar shtim fizik të stafit teknik me 6 inspektorë, me qëllim monitorimin, hetimin dhe realizimin e analizave të tregjeve dhe sektorëve të ekonomisë shqiptare, që janë në rritje dhe të larmishme. Gjithashtu, Autoriteti ka kërkuar edhe vëmendjen e institucioneve shtetërore për pajisjen me mjedise të përshtatshme të punës për stafin, duke qenë se vazhdon prej 17 vjetësh, që nga dita e themelimit deri më sot, të punojë relativisht në kushte jo të përshtatshme. Pavarësisht këtyre kërkesave, rezulton që Kuvendi nuk i ka pranuar ato në Rezolutën përkatëse për institucionin, si dhe i kërkon institucionit të bëjë përpjekje për akomodimin e nevojave buxhetore për pajisjen me ambiente të përshtatshme të punës për stafin e Autoritetit.

Kuvendi u kërkon organeve ekzekutive të të gjitha niveleve të bashkëpunojnë me Autoritetin e Konkurrencës duke zbatuar detyrimin për të kërkuar paraprakisht vlerësimin ligjor të Autoritetit të Konkurrencës për çdo projekt-akt normativ, që ka si objekt ose pasojë dhënien e të drejtave ekskluzive, kufizime sasiore apo cilësore të konkurrencës në tregje ose sektorë të ndryshëm të ekonomisë, veçanërisht për kontratat koncesionare. Gjithashtu, Kuvendi kërkon përfshirjen e Autoritetit për konsultime të përhershme në procesin e përgatitjes dhe miratimit të akteve ligjore dhe nënligjore për të siguruar një konkurrencë të lirë dhe efektive në treg.

Lidhur me Autoritetin e Konkurrencës vlen të theksohet gjithashtu, se për 2 (dy) nga anëtarët e Komisionit të Konkurrencës kishte mbaruar mandati, më konkretisht në muajin dhjetor 2021 dhe mars 2022. Rezulton se procedura për zëvendësimin e tyre është iniciuar vetëm në datën 2 mars 2022 nëpërmjet publikimit të njoftimit për kandidim në faqen zyrtare të Kryeministrisë dhe duke qenë se në përfundim të afatit të përcaktuar nuk arrihej të plotësohej numri i kandidatëve sipas parashikimeve ligjore, afati për paraqitjen e kandidaturave është shtyrë për në datën 21 maj 2022

Në këto kushte, pas zhvillimit të seancave dëgjimore me kandidatët për zëvendësimin e këtyre anëtarëve, në vijim të procedurave për këtë qëllim, Komisioni për Ekonominë dhe Financat ka kaluar emrat e konkurrentëve në seancë plenare për votim. Për sa më sipër, pas votimit në Kuvend, më datë 23.06.2022 janë zgjedhur edhe 2 anëtarët e rinj të Komisionit, ndonëse me vonesë disa mujore.

Komisioni i Prokurimit Publik në raportin e tij ka kërkuar nga Kuvendi ngritjen e një trupe zyrtarësh të prokurimit publik të certifikuar pranë autoriteteve kontraktore, operatorëve ekonomikë, organeve shqyrtuese të prokurimit, e cila sipas këtij institucioni do të sillte një impakt të qenësishëm në sistemin e prokurimit. Gjithashtu, KPP ka propozuar nxitjen e hartimit të standardeve kombëtare për një grup mallrash me përdorim të përgjithshëm, të cilat do të ndikonin në sistem në drejtim të mënyrës së hartimit të specifikimeve teknike nga ana e autoriteteve kontraktore. Por, referuar Rezolutës se Kuvendit për vitin 2022 nuk rezulton që këto kërkesa të jenë marrë në konsideratë nga Kuvendi.

Enti Rregullator i Ujrave ka kërkuar nga Kuvendi që procesi i agregimit të sektorit UK, si avantazh i ekonomisë së shkallës, të bëhet sipas principit në baza vullnetare dhe me incentiva nga qeveria qendrore duke synuar që fillimisht të bëhen 2-3 agregime të suksesshme. Sipas ERRU procesi i agregimit do të jetë pjesë e reformës për sektorin e ujit, por që akoma nuk ka një njoftim konkret nga ana e qeverisë qendrore për formën dhe detaje të tjera organizative, financiare dhe kohore për realizimin e saj.

Gjithashtu, ERRU në mënyrë të vazhdueshme ka rekomanduar që të rishikohet legjislacioni për mundësi të tjera alternative teknike për garantimin e sigurisë së objekteve, si masa teknike përforcuese kundër aksesit në to, monitorimi në distancë i objekteve me kamera, etj. Në këtë drejtim, si dhe në përmbushje të detyrave të rezolutës së Kuvendit, ERRU ka kërkuar që të rikonsiderohet edhe çështja për ngritjen e Grupit të Punës përkatës me përfaqësues nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për rishikimin e akteve dhe nën akteve ligjore përkatëse që lidhen me licensimin e shoqërive të UK. Sërish edhe në këtë rast, rezulton se Kuvendi nuk i ka marrë tërësisht në konsideratë kërkesat dhe rekomandimet e institucionit raportues. Nga ana tjetër, në vijim të sa më sipër, Kuvendi i kërkon ERRU të rekomandojë rishikimin e legjislacionit për mundësi të tjera alternative teknike për garantimin e sigurisë së ujësjellësve (monitorimin në

distancë të objekteve me kamera), për të bërë të mundur rritjen e eficiencës së stafit dhe uljen e numrit të punonjësve.

Lidhur me Komisionerin për Mbikqyrjen e Shërbimit Civil, rezulton se ky i fundit ka kërkuar nga Kuvendi që të rritet numri i trajnimeve të stafit të NJQV-ve, në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore në përputhje me legjislacionin e shërbimit civil, si dhe të krijohet një ekip kombëtar trajnerësh dhe rrjeti menaxherësh të aftë për të replikuar dhe për të ofruar programe dhe module të veçanta të trajnimit për zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil.

Gjithashtu, ky institucion ka kërkuar përgatitjen dhe zgjerimin e mjeteve të zbatimit (manuale, udhëzues, etj.) për organizimin dhe funksionimin e administratës së NJQV-ve (duke përfshirë grupimin e standardeve ligjore, praktikat më të mira/standardet dhe strukturat dhe standardet për të gjitha funksionet thelbësore të NJQV-ve), përgatitjen e përshkrimit/misionit të modelit të punës për secilën nga njësitë tipike të administratës vendore për çdo funksion/proces kryesor, si dhe përgatitjen e përshkrimit të vendeve të punës për secilën nga pozicionet tipike të punës së administratës së bashkisë.

Komisionieri ka kërkuar edhe përshtatjen e mjeteve ekzistuese të zbatimit të ligjit për burimet njerëzore të përgatitur nga DAP në tiparet e identifikuara në nivel lokal, duke marrë parasysh mundësinë e thjeshtimit të tyre për përdorimin e bashkive, si dhe zhvillimin e mëtejshëm të mjeteve dhe procedurave të MBNJ për zbatimin e legjislacionit të nëpunësve civilë të përshtatura për nevojat e njësisë së qeverisjes vendore, si dhe të vlerësohet mundësia e thjeshtëzimit të një pjese të procedurave ligjore për nevojat lokale (procedurat e rekrutimit, kërkesat arsimore për pozicione të caktuara dhe nivelet e administrimit, formularët e përshkrimit të punës, etj.).

Së fundmi, Komisioneri ka kërkuar edhe vlerësimin e nevojës së legjislacionit të ri për organizimin e administratës vendore, në veçanti nevojën e legjislacionit për "ndërmarrjet e bashkive", me qëllim që të qartësohet më tej ndarja e shërbimit civil nga pozicionet e punës me karakter ndihmës administrativ, apo mbështetës. Për sa më sipër, rezulton se Kuvendi ka kërkuar nga Komisioneri që të adresojë pranë Kuvendit nëpërmjet mekanizmave ligjorë propozimet për ndryshimet e ligjit nr. 152/2013 dhe akteve nënligjore, me qëllim zgjidhjen e problematikave të hasura gjatë zbatimit të tij, si dhe të monitorojë dhe të luajë rol aktiv në skemën e administrimit të shërbimit civil në administratën vendore, konkretisht në ndërtimin e strukturës, përcaktimin e saktë të numrit të nëpunësve civilë, qartësimin e pozicioneve të punës në raport me shërbimin civil. Gjithashtu, Kuvendi kërkon që Komisioneri të nxisë dhe të monitorojë popullimin me të dhëna të platformës së bashkëpunimit "administrata.al" nga të gjitha subjektet e shërbimit civil, si dhe të angazhohet në hartimin e bazës ligjore dhe funksionimin e platformës "administrata.al".

Sa i përket Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ky i fundit i është drejtuar Kuvendit me një set rekomandimesh, sipas së cilave mund të arrihej më së miri qëllimi i institucionit dhe misioni i këtij të fundit. Ndërkaq, gjatë diskutimeve dhe raportimit në Komision, ka patur një ftesë të fundit për miratimin e ligjit për paditë kolektive, pasi do të jetë një instrument shtesë për komisionerin dhe organizatat e shoqërisë civile, sidomos në përballje me diskriminimin e strukturuar dhe sistemik në vendin tonë. Në Rezolutën e miratuar nga Kuvendi, sipas gjetjeve tona, nuk rezulton të jenë reflektuar kërkesat e Komisionierit. Për sa më sipër, vihet re se të paktën në këto raste, Kuvendi ka marrë shumë pak ose aspak në konsideratë kërkesat dhe rekomandimet e institucioneve raportuese.

## 6.3 KËRKESA TË TJERA PËR NDRYSHIME LIGJORE

Lidhur me kërkesat sa i përket përditësimeve apo rishikimeve ligjore, Kuvendi i ka kërkuar Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare, përmes rezolutës, që të avancojë më tej punën për miratimin e projektligjit "Për fondet e pensioneve private" brenda vitit 2022, si dhe të përfundojë pjesën e mbetur të kuadrit rregullator dhe procesit të përshtatshmërisë së subjekteve me ligjet e reja për tregjet e kapitalit dhe fondeve të investimit. Gjithashtu, Kuvendi i ka kërkuar Autoritetit që të miratojë brenda vitit 2022 aktet rregullatore në zbatim të ligjit nr. 66/2020 "Për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë", si dhe të intensifikojë bashkëpunimin me autoritetet rregullatore ndërkombëtare për marrjen e eksperiencave më të mira për këtë treg.

Kuvendi pasi ka shqyrtuar veprimtarinë e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2021 ka konstatuar, se institucioni ka dhënë kontribut parësor në hartimin e projektligjit "Për mbrojtjen e të dhënave personale" të përafruar me acquis të BE-së dhe projektligjit "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 119, datë 14.9.2014, 'Për të drejtën e informimit'". Ndërkaq, Kuvendi i Shqipërisë kërkon që Zyra e Komisionerit për vitin 2022, në përmbushje të detyrave të ngarkuara me ligj, të angazhohet veçanërisht edhe në drejtim të luajtjes së rolit aktiv në përmbylljen e procedurave për modernizimin e kuadrit ligjor.

Edhe për Departamentin e Administratës Publike Kuvendi kërkon ndër të tjera, që DAP për vitin 2022 të përgatisë ndryshimet e nevojshme ligjore dhe nënligjore për procesin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore, strukturën e pagës, përmirësimin e metodologjisë së klasifikimit të pozicioneve të punës, përmirësimin e metodologjisë së vlerësimit të rezultateve të punës, pezullimit, lirimit, transferimit, me qëllim përmirësimin e përcaktimeve ligjore për këto çështje.

Sa i përket Autoritetit të Mediave Audiovizive, sipas rezolutës së vjetshme, këtij institucioni i ishte dhënë rekomandim nga Kuvendi, që të jepte kontributin e tij në procesin e transpozimit në legjislacionin kombëtar të Direktivës së BE-së 2010/13/BE "Për koordinimin e disa dispozitave të parashikuara me ligj, rregullore apo akte administrative në shtetet anëtare, lidhur me ofrimin e shërbimit të transmetimeve me zë dhe figurë", e cila ka pësuar ndryshime në fund të vitit 2018. Këto ndryshime, ndër të tjera, synojnë mbrojtjen më të mirë të të miturve, rregulla të reja për platformat online, ndryshime në rregullat e komunikimeve me natyrë tregtare.

Në kudër të kontributit të AMA-s në procesin e transpozimit të Direktivës së BE-së 2018/1808, në cilësinë e Autoritetit rregullator të shërbimeve audio/audiovizive në RSH, sipas raportimit të autoritetit rezulton që AMA ka realizuar një punë paraprake me qëllim njohjen me ndryshimet e Direktivës 2010/13 "Për shërbimin mediatik me zë dhe figurë për mediat audiovizive".

Në vijim të sa më sipër, AMA, me shkresën nr. 2682 prot., datë 06.08.2021, i është drejtuar Kuvendit dhe Ministrisë së linjës për inicimin e procesit të transpozimit të Direktivës 2018/1808. Referuar ndryshimeve që sjell kjo Direktivë, procesi i transpozimit kërkon përfshirjen edhe të institucioneve të tjera, për çështje të caktuara. Në këto kushte, përmes rezolutës së këtij viti, Autoritetit i është lënë detyrë të koordinojë punën edhe me institucionet e tjera që duhet të kontribuojnë për të bërë të mundur transpozimin e pjesshëm brenda vitit 2022 të Direktivës së BE-së 2010/13/BE "Për koordinimin e disa dispozitave të parashikuara me ligj, rregullore apo akte administrative në shtetet anëtare lidhur me ofrimin e shërbimit të transmetimeve me zë dhe figurë", për mbrojtjen e fëmijëve, reklamën, juridiksionin, aksesueshmërinë e personit me aftësi të kufizuara etj.

Ndërkaq, po sipas rezolutës së këtij viti, Autoritetit i është lënë, ndër të tjera, detyrë që të propozojë ndryshimet e nevojshme për përmirësimin e legjislacionit për reklamat publike në përputhje me standardet ndërkombëtare. Gjithashtu, si një institucion me ekspertizën e duhur teknike, Autoritetit i është dhënë rekomandim të japë kontributin e tij gjatë fazës së rishikimit në Kuvend të ndryshimeve ligjore të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, si për sa i takon krijimit të një kuadri rregullator për mediat online, si një realitet i ri në industrinë mediatike, ashtu edhe të adresimit të opinionit të Komisionit të Venecias, për të bërë të mundur që këto ndryshime të jenë në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe parimet e lirisë së medias.

Lidhur me AMA, vlen të theksohet se më datë 17.01.2022 Kuvendi i Shqipërisë votoi gjashtë emrat e përzgjedhur nga Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik për vendet vakante në Autoritetin e Medias Audiovizive. AMA ishte që prej vitit 2019 me 3 vakanca, ndërsa 3 të tjera u krijuan në vitin 2021. Disa përpjekje të shumicës për të plotësuar ato gjatë legjislaturës së kaluar pa praninë e opozitës zyrtare dështuan, ndërsa u akuzuan si përpjekje

për marrje kontrolli të institucionit. Në qershor të vitit të kaluar, pavarësisht kontestimeve nga organizatat e medias, shumica procedoi duke përzgjedhur kryetaren e AMA-s.

Autoriteti i Konkurrencës ka raportuar se në janar 2022, ka ngritur një grup pune për realizimin e amendimeve të ligjit nr. 9121/2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", i ndryshuar. Në përfundim të këtij procesi, drafti përfundimtar i këtyre amendimeve do të kalojë në procedurat e parashikuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Këto procedura do të realizohen në bashkëpunim dhe me mbështetjen e Komisionit për Ekonominë dhe Financat dhe Komisionit të Ligjeve në Kuvendin e Shqipërisë. Për sa më sipër, Autoriteti raporton se është në proces të përgatitjes së draftit të amendimeve të ligjit nr. 9121/2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", i ndryshuar. Në këto kushte, Kuvendi i kërkon tashmë Autoritetit të përfshijë sa më parë ndryshimet për rishikim të ligjit nr. 9121/2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", të ndryshuar, në procesin e konsultimit publik, me qëllim paraqitjen e tyre në Kuvend brenda vitit 2022.

Komisioni i Prokurimit Publik ka propozuar ndryshimin e nenit 109 të ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", duke shtuar të drejtën për të vënë në lëvizje Komisionin e Prokurimit Publik (rregullimin e interesit të ligjshëm-legjitimimin substancial (ad causam). Gjithashtu, KPP ka propozuar edhe shfuqizimin e pikës 2 të nenit 115 të ligjit nr.162/2020, ndryshim ky lidhur me veprimet procedurale të Komisionit të Prokurimit Publik në kuadër të shqyrtimit të ankesave, me synim rritjen e shpejtësisë dhe eficiencës. Referuar Rezolutës se Kuvendit për vitin 2022 nuk rezulton që këto kërkesa të jenë marrë në konsideratë nga Kuvendi.

Lidhur me propozimet e tjera për ndryshime ligjore në legjislacionin aktual, theksojmë se edhe Autoriteti për të Drejtën e Informimit mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, në kuadër të takimit që Kryetarja e Kuvendit ka pasur me titullarët e organeve kolegjiale në varësi të Kuvendit të Shqipërisë, ka paraqitur disa problematika që i ka hasur në punën e tij 5-vjeçare, të cilat përkthehen në propozime të mundshme për të bërë disa ndryshime apo shtesa në ligjin nr. 8480, datë 27/05/1999, "Për Funksionimin e Organeve Kolegjiale", apo të ndonjë ligji tjetër, të cilat do të ndikonin në cilësinë e punës të organeve kolegjiale në Republikën e Shqipërisë dhe të Autoritetit në veçanti.

Këto ndryshime do të lidheshin kryesisht me vazhdimësinë e mandateve të anëtarëve gjatë përiudhës tranzitore deri në zgjedhjet e reja për anëtarët e rinj, përcaktimin e afateve prekluzive për zëvendësimin e anëtarëve, përcaktimin e penaliteteve për anëtarët që bojkotojnë ushtrimin e detyrave funksionale, zbatimin e etikës nga anëtarët e organit kolegjial, zbardhjen në kohë reale të vendimmarrjes në mbledhje, si dhe përcaktimin e disa rasteve kur vota e titullarit të institucionit është prevaluese.

Gjithashtu, referuar raportimit të Autoritetit, në pikën 3 të nenit 22/1 "Bashkëpunimi për identifikimin dhe rikuperimin e trupave të të zhdukurve dhe të të ekzekutuarve, si dhe masat për ruajtjen e vendvarrimeve" të ligjit 45/2015, datë 30.4.2015 "Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", i

ndryshuar, legjislatori ka parashikuar se: "Autoritetet përgjegjëse dhe mënyra e mbrojtjes dhe ruajtjes së vendvarrimeve të identifikuara ose të dyshuara përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave".

Në këtë kontekst, referuar implementimit të dispozitës së sipërcituar, problematikës së krijuar në vijimësi të këtij procesi, sipas Autoritetit është parësor miratimi i këtij akti nga Këshilli i Ministrave, në të cilin duhet të pasqyrohen qartë detyrat e çdo institucioni që përfshihet në këtë proces. Për sa më sipër, Autoriteti zotohet të japë edhe kontributin e vet në përgatitjen e një draft/akti, kryesisht në përcaktimin e detyrave të veta në këtë proces, por dhe më gjerë, në kuadër të bashkëpunimit me institucionet e tjera shtetërore qendore dhe vendore. Një rekomandim në këtë drejtim është dhënë edhe nga rezoluta e miratuar nga Kuvendi.

Përmes Rezolutës për vitin 2022, Kuvendi i ka kërkuar Autoritetit të vijojë angazhimin për hartimin e draftit të aktit nënligjor që do të përcaktojë autoritetet përgjegjëse dhe mënyrën e mbrojtjes dhe ruajtjes së vendvarrimeve të identifikuara ose të dyshuara duke dhënë kontribut në përcaktimin e detyrave të AIDSSH në këtë proces, por dhe më gjerë, në kuadër të bashkëpunimit me institucionet e tjera shtetërore qëndrore dhe vendore.

Sa i përket Këshillit të Lartë Gjyqësor, Kuvendi i kërkon të përmbyllë miratimin e gjithë akteve nënligjore që përcaktohen në ligjet e reformës në drejtësi, si dhe në bashkëpunim me Këshillin e Lartë të Prokurorisë të miratohen rregullat e përbashkëta për bashkimin e procedimeve në rastin kur një gjyqtar dhe një prokuror janë përfshirë në të njëjtën shkelje. Gjithashtu, Kuvendi i kërkon KLGJ që të vijojë me dhënien e opinioneve dhe vlerësimeve për përmirësimet ligjore në përputhje me përcaktimet e nenit 187 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë".

Edhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë Kuvendi i kërkon të përmbyllë në një kohë sa më të shkurtër hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore sipas përcaktimeve në ligjet e reformës së drejtësisë, si dhe hartimin, miratimin dhe zbatimin e rregullave më të detajuara për formimin fillestar dhe atë vazhdues për nëpunësit e tjerë civilë të prokurorisë. Lidhur me KLP, vlen të përmendet se po vijojnë procedurat për përzgjedhjen e kandidatit për anëtar të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga trupa e pedagogëve të fakulteteve të drejtësisë dhe të shkollës së Magjistraturës, ku deri tani janë zhvilluar dëgjesat me 4 kandidatët e kualifikuar, të cilët janë vlerësuar në raportin e Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit se plotësojnë kushtet e parashikuara nga Kushtetuta dhe ligji "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", për të qenë anëtarë të Këshillit të Lartë Prokurorisë.

Sa i përket Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Kuvendi ka kërkuar hartimin e dispozitave të hollësishme për administrimin e sistemit të menaxhimit të çështjeve për procedurën hetimore, si dhe bërjen publik të informacionit të pjesshëm sipas përcaktimit të ILD në përputhje dhe në zbatim të nenit 137 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë". Gjithashtu, Kuvendi i kërkon ILD vijimin me ritme të shpejta të punës për hartimin e rregullores për trajtimin e ankesave dhe hartimin e një metodologjie të

përgjithshme inspektimi.

Në vijim të rekomandimeve për institucionet e pavarura të drejtësisë, lidhur me ndryshimet ligjore, Kuvendi i kërkon Prokurorit të Përgjithshëm të vijojë puna e nisur për përditësimin e manualit për pastrimin e parave dhe rikuperimin e aseteve, në kuadrin e Projektit FIIAPP, si dhe të angazhohet në procesin e zbatimit të hartës së re gjyqësore, duke synuar garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të individit, me theks të veçantë tek e drejta e aksesit në drejtësi.

Lidhur me Inspektoriatin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Kuvendi kërkon që Inspektoriati të adresojë në mënyrë të efektshme rekomandimet e lëna nga organizatat ndërkombëtare përshirë dhe rekomandimet e lëna në Raportin e Vlerësimit të Grupit të Shteteve të Këshillit të Evropës kundër Korrupsionit (GRECO), në drejtim të përmbushjes së angazhimeve të ndërmarra në kuadër të proceseve integruese, si dhe të krijojë instrumente të qëndrueshëm në veprimtarinë e saj që mundësojnë fuqizimin e rolit proaktiv në drejtim të monitorimit sistematik të njësive përgjegjëse për zbatimin efektiv të ligjit nr. 60/2016 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve".

Lidhur me KQZ, në Rezolutën për vitin 2022, Kuvendi kërkon të rishikohen proceset e punës dhe aktet nënligjore për eliminimin e problematikave të identifikuara përgjatë procesit të administrimit zgjedhor nga Komisionet e Qendrave të Votimit, si dhe të miratohen aktet nënligjore, në zbatim të përcaktimeve të Kodit Zgjedhor, për të mundësuar votimin e shtetasve shqiptare me banim jashtë vendit.

Gjithashtu, Kuvendi i kërkon KQZ  që të kontribuojë në ruajtjen e garancive ligjore që lidhen me mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut dhe të shtohen parashikime të detajuara në aktet nënligjore, për krijimin e lehtësive për votimin e personave me aftësi ndryshe, në qendrat e votimit

## 6.4 DISKUTIMET GJATË RAPORTIMEVE TË INSTITUCIONEVE NË KUVEND

Lidhur me këtë pikë vlen të thuhet se gjatë raportimeve të institucioneve, herë pas here diskutimet shoqërohen edhe me pyetje nga anëtarët e Komisioneve apo me debate lidhur me tema të caktuara që trajtohen. Sa i përket institucioneve të cilët tashmë, jo vetëm kanë raportuar, por edhe për të cilët është miratuar një rezolutë, ka patur interes nga Kuvendi në vetëm disa raste lidhur me objektin e raportimit.

Më konkretisht, gjatë raportimit të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, një pyetje e ardhur nga anëtarët e komisionit kishte të bënte më mundësinë e fshirjes nga  AKEP-i të të dhënave që në formë imazhesh ose përmbajtjesh linçojnë ose degradojnë dikë.

Ndërsa, gjatë raportimit të Autoritetit të Konkurrencës një pyetje e lindur kishte të bënte me faktin nëse janë marrë masa për të ndryshuar situatën e tenderimeve publike dhe prokurimeve publike nga ana e qeverisë.

Vihet re se raportimi ka qenë intensiv nga pikëpamja e pyetjeve të ardhura nga anëtarët e komisionit, gjatë kohës që ka raportuar Enti Rregullator i Energjisë. Më konkretisht, institucioni është pyetur lidhur me arsyet përse është lejuar që KESH-i dhe OSHEE-ja të blejnë energji jashtë tregut të formalizuar në bursë, apo për arsyet se përse është lejuar që KESH-i të prodhojë energji elektrike, veçanërisht në muajt korrik dhe gusht, duke çuar në rënien e nivelit të liqenit të Fierzës në kuota shumë më të ulëta se mesatarja historike. Gjithashtu, interes është shfaqur edhe për politikat e institucionit, etj. Pra, evidentohet një interes i shtuar lidhur me tema të caktuara nga anëtarët e komisioneve. Nga ana tjetër edhe INSTAT dhe Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit janë përballur me shumë pyetje gjatë raportimit, pyetje të cilat lidheshin me veprimtarinë e institucioneve, apo politikave të tjera të këtyre të fundit.

Vlen të thuhet se institucionet jo gjithmonë tregohen të gatshëm për tu përgjigjur aty për aty, pasi shpeshherë kërkojnë edhe kohë për të kthyer përgjigje me shkrim ndaj Kuvendit. Ndërkaq, në shumë raste evidentohet fakti se pyetjet jo gjithmonë janë relevante me natyrën e raportimit duke u ngatërruar edhe me kontekstin politik. Madje, gjatë raportimeve, shpeshherë evidentohet se debati nga dhe mes anëtarëve të komisioneve është përqendruar vetëm në tema politike, duke shpërqendruar vëmendjen nga çështjet që lidhen me raportimin.

Element tjetër i konstatuar në raportimet e institucioneve është mungesa e përfaqësuesve të shoqërisë civile gjatë zhvillimit të seancave. Nga vëzhgimet e kryera, si duke ndjekur seancat ashtu edhe referuar procesverbaleve të seancave, nuk arrihet të evidentohet prania e shoqërisë civile apo qoftë edhe të flitet për mungesën e përfaqësuesve të saj nga të pranishmit në seancë. Vlen të theksohet se një mungesë e tillë nuk është trajtuar nga të dyja palët, si nga përfaqësuesit e shumicës parlamentare, ashtu edhe nga të pakicës. Ndërkaq, vlen të përmendet gjithashtu se disa institucione, të tilla si Këshilli i Lartë Gjyqësor, kanë përfshirë në raportimet e tyre edhe përmbushjen e rekomandimeve të ardhura nga përfaqësues të shoqërisë civile apo organizatave jofitimprurëse në drejtim të përmirësimit të veprimtarisë së tyre.

Nga ana tjetër, Kuvendi, në Rezolutën e miratuar lidhur me Inspektoriatin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, i ka kërkuar këtij të fundit të forcojë bashkëpunimin me shoqërinë civile, median dhe publikun e gjerë për informacionet e dhëna për rastet e denoncimit të shkeljes së ligjit për deklarimin e interesave private pasurore, për rastet e identifikimit të konfliktit të interesave, si dhe rastet e dyshuara të korrupsionit në sektorin publik dhe privat.

## 6.5 KËRKESAT DREJTUAR KUVENDIT NGA KËSHILLI DREJTUES RTSH

Sa i përket kërkesave drejtuar Kuvendit përmes raportit të këtij viti nga Këshilli Drejtues i Radio Televizionit Shqiptar, apo gjatë raportimit të këtij të fundit në komisionin përkatës, rezulton se ky institucion ka kërkuar mbështetje në burime njerëzore dhe financiare për procesin e digjitalizimit të arkivës, si dhe mbështetje financiare për të rivitalizuar disa aspekte të televizionit, që do të ndihmojnë në krijimin e një imazhi të ri të RTSH, siç mund të jenë investimet në studio të reja, integrim më të lartë të artistëve, më shumë të rinj të angazhuar, teknologji e përditësuar, etj.

Referuar projekt-rezolutës për këtë qëllim, rezulton se këto kërkesa janë miratuar nga Kuvendi, megjithatë pritet të shihet rezoluta përfundimtare e Kuvendit. Ndërkaq, vlen të theksohet se lidhur me Këshillin Drejtues të Radio Televizionit Shqiptar, Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik në mbledhjen e datës 16.03.2022, me vendimin nr.7/2022, vendosi shpalljen e dy vendeve vakante për anëtarë të Këshillit, duke ftuar të gjithë kandidatët që plotësojnë kriteret ligjore që brenda datës 15.04.2022, të paraqisnin dokumentacionin e nevojshëm për kandidim.

Në zbatim të nenit 94, të ligjit nr. 97/2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar", në datën 08.06.2022, Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik organizoi seancën dëgjimore me kandidaturat e paraqitura në Kuvend. Në përfundim të afatit të vendosur për dorëzimin e dokumentacionit, u depozituan në Kuvend dhe u paraqitën në seancë dëgjimore 9 (nëntë) kandidatë. Pas shqyrtimit të kritereve ligjore, meritës, eksperiencës profesionale, si dhe nivelit të prezantimit në seancën dëgjimore, në mbledhjen e datës 06.07.2022, Komisioni përzgjodhi dhe miratoi me të gjithë votat e deputetëve të pranishëm, 2 (dy) kandidatura, mbështetur nga pakica parlamentare dhe ia ka propozuar seancës plenare për miratim.

## 6.6 KONKLUZIONE

Referuar gjetjeve të deritanishme, duke marrë në konsideratë vlerësimet për institucionet sipas rezolutave të Kuvendit të miratuara deri më datë 27.07.2022, si dhe duke i'u referuar raportit të depozituar nga Këshilli Drejtues i Radio Televizionit Shqiptar për të cilin nuk ka ende një rezolutë, apo edhe raportimeve në komisione nga institucionet raportuese, konstatojmë se vetëm 10 institucione nga 26 të tilla, kanë përmbushur rekomandimet dhe detyrat e lëna nga Kuvendi gjatë vitit të shkuar.

Ndërkaq, 12 institucione kanë përmbushur pothuajse plotësisht rekomandimet dhe detyrat, ndërsa 4 institucione kanë përmbushur vetëm pjesërisht detyrat dhe rekomandimet e lëna në rezolutat përkatëse. Pra, evidentohet qartësisht se nga ana e institucioneve shqiptare ka një përmbushje rezolutash pothuajse në nivelin mesatar.

Nëse do të na duhej të bënim një përmbledhje në formë grafike të nivelit të përmbushjes së rezolutave nga 26 (njëzetë e gjashtë) institucionet shqiptare të përmendura më sipër, ajo do të ishte si vijon, në figurën 2 më poshtë:




Sikurse e theksuam edhe më sipër, deri tani janë miratuar rezoluta për 25 institucione nga 26 të tilla. Ndërkaq, Këshilli Drejtues i Radio Televizionit Shqiptar ka depozituar tashmë raportin, ka raportuar verbalisht pranë komisionit përkatës, si dhe është miratuar madje edhe projekt rezoluta për këtë institucion, por mbetet sakaq vetëm miratimi i rezolutës për të, ku do të evidentohet se sa janë marrë në konsideratë kërkesat e këtij institucioni drejtuar Kuvendit dhe se si është vlerësuar performanca e tij gjatë vitit që lamë pas. Lidhur me kërkesat drejtuar Kuvendit, rezulton që institucionet në përgjithësi nuk janë shumë aktive në këtë drejtim, pra në adresimin e nevojave të tyre kundrejt Kuvendit, përmes raporteve të depozituara apo edhe raportimeve verbale nëpër komisionet përkatëse nga përfaqësuesit e institucioneve. Për sa më sipër, rezulton se vetëm 10 nga 26 institucione i kanë adresuar kërkesa Kuvendit deri më datë 27.07.2022.

Sa i përket natyrës së kërkesave drejtuar Kuvendit nga institucionet raportues, vlen të thuhet se ato janë kryesisht të lidhura me aspektin financiar të veprimtarisë së institucioneve. Në disa raste kërkohet edhe shtim i personelit, ndërsa në disa raste kërkohen ndryshime ligjore lidhur me fusha të caktuara rregullative të institucionit me qëllim realizimin sa më të mirë të misionit të tij, në përputhje edhe me rekomandimet e Kuvendit.

Sikurse e përmendëm edhe më sipër, element tjetër i konstatuar gjatë raportimeve të institucioneve është mungesa e përfaqësuesve të shoqërisë civile gjatë seancave. Nga vëzhgimet e kryera, si duke ndjekur seancat ashtu edhe referuar procesverbaleve të seancave, nuk arrihet të evidentohet prania e shoqërisë civile apo qoftë edhe konstatimi i mungesës së përfaqësuesve të saj nga të pranishmit në seancë.

Vlen të theksohet se një mungesë e tillë nuk është trajtuar nga të dyja palët, si nga përfaqësuesit e shumicës parlamentare, ashtu edhe nga të pakicës. Ndërkaq, disa institucione, të tilla si Këshilli i Lartë Gjyqësor, kanë përfshirë tashmë paraprakisht në raportimet e tyre edhe përmbushjen e rekomandimeve të ardhura gjatë vitit paraardhës nga përfaqësues të shoqërisë civile apo organizatave jofitimprurëse në drejtim të përmirësimit të veprimtarisë së tyre.

Kuvendi, lidhur me Inspektoriatin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, i ka kërkuar këtij të fundit të forcojë bashkëpunimin me shoqërinë civile, median dhe publikun e gjerë për informacionet e dhëna për rastet e denoncimit të shkeljes së ligjit për deklarimin e interesave private pasurore, për rastet e identifikimit të konfliktit të interesave, si dhe rastet e dyshuara të korrupsionit në sektorin publik dhe privat.

Rezulton se edhe Kuvendi ka patur interes për çështje të caktuara gjatë raportimit nga institucionet, por referuar procesverbaleve të seancave, si dhe diskutimeve të ndjekura gjatë zhvillimit të tyrë nëpër komisione, rezulton se shpeshherë ato zhvendosen më shumë në çështje me përmbajtje politike se sa lidhur me vlerësimin e performancës së institucionit raportues.

Megjithatë, sikurse e përmendëm edhe më sipër, në raste të caktuara temat e cekura nga anëtarët e komisioneve janë relevante me raportimin. Në të tilla raste, referuar gjetjeve, rezulton se institucioni raportues zgjedh më së shumti të përgjigjet me shkrim, se sa aty për aty verbalisht, me qëllim dhënien e një informacioni sa më shterues.

Në rezolutat e miratuara, referuar gjetjeve rezulton se Kuvendi është përqendruar më së shumti në rekomandime që lidhen me ndryshime ligjore duke kërkuar nga institucionet kontribut më aktiv në këtë drejtim, me qëllim trajtimin e problematikave të evidentuara gjatë veprimtarisë së institucioneve.

# 7. ANEKS ME TË DHËNA TË DETAJUARA PËR DEPUTETËT

## TABELA ME RENDITJEN E DEPUTETËVE MBI BAZËN E KRITEREVE TË VLERËSIMIT

Për transparencë të sistemit të vlerësimit të deputetëve: përgjegjësia e deputetëve është shqyrtimi, diskutimi, votimi i akteve ligjore, e drejta e nismave ligjore, e drejta e amendimeve ligjore, e drejta e propozimeve ligjore e politike, e drejta e interpelancës, e drejta e kërkesave për informacion, e drejta dhe përgjegjësia e aktivitetit në zonën elektorale, etj.

- në vlerësimin e nismave ligjore përfshihen deputetët që kanë iniciuar ligje konkrete si individë ose në grup deputetësh,
- në vlerësimin e propozimeve ligjore dhe politike futen deputetët që kanë iniciuar amendamente konkrete në komisionet parlamentare ose në seancë,
- në vlerësimin e diskutimeve dhe kontributeve në seancat plenare përfshihen deputetët që kanë pasur angazhime përmes fjalimeve dhe ndërhyrjeve,
- në vlerësimin e pjesëmarrjes dhe diskutimeve në komisione përfshihen deputetët që kanë ushtruar dy funksionet, pjesëmarrjen dhe diskutimet,
- në diskursin dhe sjelljen parlamentare jepet vlerësimi për deputetët në raport me përgjegjësitë parlamentare, në kategorinë e interpelancave vlerësohen deputetët sipas kërkesave dhe nismave,
- në vlerësimin e interpelancave përfshihen deputetët që kanë kërkuar dhe realizuar interpelanca si individë apo në grup,
- në votimin e akteve ligjore vlerësohen deputetët sipas nivelit të pjesëmarrjes në votime,
- në aktivitetin në zonë dhe në publik vlerësohen deputetët sipas nivelit të angazhimit,
- vlerësimi final bën përllogaritjen e përgjithshme të treguesve, duke zbritur rastet e penalizimit të deputetëve nga Kuvendi për shkelje të etikës apo shkelje të tjera.

## TË DHËNAT E DETAJUARA SIPAS KRITEREVE TË VLERËSIMIT TË EFIKASITETIT TË DEPUTETËVE

| | EMRI & MBIEMRI | GRUPI POLITIK | NISME LIGJORE | PROPO-ZIME LIGJORE POLITIKE | DISK SEANCË | PJES+DISK KOMISION | DISKURS + SJELLJE PARLAME-NTARE | INTER-PELANCE | VOTIM I LIGJEVE % | PUBLIK ZONË | FINALE |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | **Jorida Tabaku** | PD | 5 | 9 | 12.4 | 19.1 | 9 | 5 | 6.4 | 10 | **75.9** |
| 2 | **Erion Braçe** | PS | 10 | 9 | 9.0 | 11.5 | 9 | 10 | 7.2 | 10 | **75.7** |
| 3 | **Bujar Leskaj** | PD | 5 | 8 | 15.9 | 14 | 8 | 0 | 9.6 | 10 | **70.5** |
| 4 | **Ina Zhupa** | PD | 5 | 3 | 16.6 | 16 | 4 | 10 | 8.8 | 7 | **70.4** |
| 5 | **Petrit Vasili** | LSI | 10 | 5 | 17.2 | 16 | 3 | 0 | 9.9 | 9 | **70.1** |
| 6 | **Enkelejd Alibeaj** | PD | 10 | 8 | 9.7 | 11.54 | 5 | 0 | 9.4 | 10 | **63.6** |
| 7 | **Taulant Balla** | PS | 5 | 7 | 16.6 | 5.72 | 6 | 0 | 10 | 10 | **60.3** |
| 8 | **Arben Pëllumbi** | PS | 5 | 5 | 4.1 | 20 | 3 | 0 | 9.5 | 6 | **52.6** |
| 9 | **Petro Koçi** | PS | 0 | 3 | 9.0 | 19 | 3 | 0 | 10 | 7 | **51.0** |
| 10 | **Klotilda Bushka** | PS | 0 | 4 | 9.7 | 18.84 | 3 | 0 | 10 | 5 | **50.5** |
| 11 | **Emilja Koliqi** | PD | 0 | 5 | 6.9 | 19.2 | 5 | 0 | 9.2 | 5 | **50.3** |
| 12 | **Dashamir Shehi** | LZHK | 5 | 5 | 9.0 | 9.8 | 6 | 0 | 9.2 | 6 | **50.0** |
| 13 | **Dashnor Sula** | PD | 0 | 5 | 11.0 | 11.92 | 6 | 0 | 8.4 | 7 | **49.4** |
| 14 | **Tritan Shehu** | PD | 0 | 4 | 15.2 | 16.11 | 3 | 0 | 6 | 5 | **49.3** |
| 15 | **Dhurata Çupi** | PD | 0 | 5 | 9.0 | 15.71 | 4 | 0 | 9.3 | 6 | **49.0** |
| 16 | **Eduard Shalsi** | PS | 0 | 6 | 4.1 | 18 | 5 | 0 | 10 | 5 | **48.1** |
| 17 | **Antoneta Dhima** | PS | 0 | 1 | 11.7 | 16 | 3 | 0 | 10 | 6 | **47.7** |
| 18 | **Ferdinant Xhaferaj** | PD | 0 | 6 | 2.1 | 13 | 5 | 10 | 5.2 | 6 | **47.3** |
| 19 | **Grida Duma** | PD | 0 | 4 | 9.0 | 16.66 | 4 | 0 | 6.5 | 7 | **47.1** |
| 20 | **Erisa Xhixho** | LSI | 0 | 6 | 6.2 | 8.26 | 5 | 0 | 9.3 | 10 | **44.8** |
| 21 | **Saimir Korreshi** | PD | 0 | 4 | 8.3 | 9.61 | 5 | 0 | 8.4 | 9 | **44.3** |
| 22 | **Etilda Gjonaj** | PS | 0 | 3 | 4.1 | 18 | 3 | 0 | 8.8 | 7 | **43.9** |
| 23 | **Edmond Spaho** | PD | 5 | 5 | 10.3 | 14.6 | 3 | 0 | 6 | 5 | **43.9** |
| 24 | **Luçiano Boçi** | PD | 0 | 5 | 7.6 | 14 | 5 | 0 | 4.8 | 7 | **43.4** |
| 25 | **Xhelal Mziu** | PD | 0 | 3 | 3.4 | 15.7 | 3 | 5 | 8 | 5 | **43.1** |
| 26 | **Arbi Agalliu** | PD | 0 | 5 | 5.5 | 14.1 | 4 | 0 | 8 | 6 | **42.6** |
| 27 | **Anila Denaj** | PS | 0 | 3 | 7.6 | 13.4 | 3 | 0 | 9.4 | 6 | **42.4** |
| 28 | **Nasip Naço** | PS | 0 | 4 | 2.8 | 19.33 | 3 | 0 | 9.9 | 3 | **42.0** |
| 29 | **Mimi Kodheli** | PS | 0 | 3 | 3.4 | 18.6 | 4 | 0 | 7.9 | 5 | **41.9** |
| 30 | **Ervin Salianji** | PD | 0 | 4 | 6.9 | 7.09 | 4 | 5 | 7.6 | 7 | **41.6** |
| 31 | **Orjola Pampuri** | PD | 0 | 5 | 6.9 | 12.77 | 4 | 0 | 6.6 | 5 | **40.3** |
| 32 | **Kreshnik Çollaku** | PD | 0 | 3 | 9.0 | 13.5 | 3 | 0 | 6.8 | 5 | **40.3** |
| 33 | **Agron Shehaj** | PD | 0 | 5 | 3.4 | 1.8 | 7 | 10 | 4.9 | 8 | **40.1** |
| 34 | **Oerd Bylykbashi** | PD | 0 | 6 | 4.8 | 11.92 | 6 | 0 | 2.8 | 8 | **39.5** |
| 35 | **Etjen Xhafaj** | PS | 0 | 2 | 4.8 | 14.3 | 3 | 0 | 10 | 5 | **39.1** |
| 36 | **Vangjel Dule** | PBDNJ | 0 | 3 | 6.9 | 14.3 | 3 | 0 | 8.8 | 3 | **39.0** |
| 37 | **Albana Vokshi** | PD | 0 | 3 | 5.5 | 5.56 | 5 | 5 | 6.8 | 8 | **38.9** |
| 38 | **Ermonela Felaj** | PS | 0 | 2 | 6.2 | 12.5 | 3 | 0 | 9.8 | 5 | **38.5** |
| 39 | **Denis Deliu** | PS | 0 | 2 | 7.6 | 12.68 | 3 | 0 | 10 | 3 | **38.3** |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 40 | **Eduard Ndreca** | PS | 0 | 3 | 4.1 | 14.03 | 3 | 0 | 10 | 4 | **38.2** |
| 41 | **Zef Hila** | PD | 0 | 3 | 2.1 | 7.7 | 3 | 10 | 6.9 | 5 | **37.7** |
| 42 | **Fatmir Xhafaj** | PS | 0 | 7 | 2.1 | 6.72 | 6 | 0 | 9.6 | 6 | **37.4** |
| 43 | **Fadil Nasufi** | PS | 0 | 3 | 4.1 | 14.1 | 3 | 0 | 10 | 3 | **37.2** |
| 44 | **Klodiana Spahiu** | PS | 0 | 2 | 4.8 | 15 | 3 | 0 | 9 | 3 | **36.8** |
| 45 | **Alban Xhelili** | PS | 0 | 1 | 3.4 | 17.4 | 2 | 0 | 9.5 | 3 | **36.4** |
| 46 | **Agron Duka** | PAA | 0 | 5 | 3.4 | 11.3 | 5 | 0 | 4.5 | 7 | **36.2** |
| 47 | **Xhemal Qefalia** | PS | 0 | 3 | 2.1 | 15.04 | 3 | 0 | 10 | 3 | **36.1** |
| 48 | **Ismet Beqiraj** | PS | 0 | 2 | 2.8 | 17.2 | 2 | 0 | 10 | 2 | **36.0** |
| 49 | **Blerina Gjylameti** | PS | 0 | 3 | 4.8 | 11.5 | 3 | 0 | 9.5 | 4 | **35.8** |
| 50 | **Enslemvera Zake** | PS | 0 | 2 | 4.8 | 13.1 | 3 | 0 | 9.9 | 3 | **35.8** |
| 51 | **Lefter Gështenja** | PD | 0 | 2 | 8.3 | 14.7 | 2 | 0 | 5.8 | 3 | **35.8** |
| 52 | **Helidon Bushati** | PD | 0 | 4 | 2.8 | 16.1 | 5 | 0 | 2.8 | 5 | **35.7** |
| 53 | **Agron Gjekmarkaj** | PD | 0 | 3 | 4.1 | 6.2 | 6 | 0 | 6.3 | 10 | **35.6** |
| 54 | **Klevis Xhoxhi** | PS | 0 | 2 | 2.8 | 15.56 | 2 | 0 | 10 | 3 | **35.3** |
| 55 | **Sali Berisha** | PG/PD | 0 | 4 | 15.2 | 0 | 4 | 0 | 1.9 | 10 | **35.1** |
| 56 | **Ilda Dhori** | PD | 0 | 2 | 4.1 | 13 | 3 | 0 | 7.8 | 5 | **34.9** |
| 57 | **Pranvera Resulaj** | PS | 0 | 2 | 4.8 | 12.28 | 3 | 0 | 9 | 3 | **34.1** |
| 58 | **Pandeli Majko** | PS | 0 | 3 | 3.4 | 8.45 | 4 | 0 | 9.1 | 6 | **34.0** |
| 59 | **Vullnet Sinaj** | PS | 0 | 3 | 6.2 | 9.47 | 3 | 0 | 9.3 | 3 | **34.0** |
| 60 | **Bardhyl Kollçaku** | PS | 0 | 2 | 2.1 | 13.71 | 3 | 0 | 10 | 3 | **33.8** |
| 61 | **Laert Duraj** | PS | 0 | 2 | 2.8 | 15 | 2 | 0 | 10 | 2 | **33.8** |
| 62 | **Fatmir Mediu** | PR | 0 | 3 | 6.2 | 8.46 | 4 | 0 | 7.8 | 4 | **33.5** |
| 63 | **Eralda Bano** | PD | 0 | 2 | 4.1 | 11.4 | 3 | 0 | 9.1 | 3 | **32.6** |
| 64 | **Baftjar Zeqaj** | PS | 0 | 2 | 2.8 | 12.8 | 2 | 0 | 10 | 3 | **32.6** |
| 65 | **Sorina Koti** | PD | 0 | 3 | 6.2 | 12.3 | 3 | 0 | 3.9 | 4 | **32.4** |
| 66 | **Ilir Metaj** | PS | 0 | 2 | 4.1 | 12 | 2 | 0 | 9 | 3 | **32.1** |
| 67 | **Gazment Bardhi** | PD | 0 | 5 | 2.1 | 7.88 | 4 | 0 | 7.1 | 6 | **32.0** |
| 68 | **Toni Gogu** | PS | 0 | 3 | 6.9 | 5.93 | 3 | 0 | 8.8 | 4 | **31.6** |
| 69 | **Mirela Pitushi** | PS | 0 | 2 | 2.8 | 12.77 | 2 | 0 | 10 | 2 | **31.5** |
| 70 | **Luan Baçi** | PD | 0 | 3 | 9.7 | 7 | 3 | 0 | 4.5 | 4 | **31.2** |
| 71 | **Florenc Spaho** | PS | 0 | 2 | 3.4 | 11.66 | 2 | 0 | 10 | 2 | **31.1** |
| 72 | **Flamur Noka** | PD | 0 | 4 | 4.8 | 5.47 | 2 | 5 | 4.8 | 5 | **31.1** |
| 73 | **Lavdrim Krrashi** | PS | 0 | 2 | 1.4 | 12.19 | 3 | 0 | 9.5 | 3 | **31.1** |
| 74 | **Luljeta Bozo** | PS | 5 | 2 | 0.7 | 7.7 | 3 | 0 | 9.4 | 3 | **30.8** |
| 75 | **Hatixhe Konomi** | PS | 0 | 2 | 2.1 | 11.5 | 2 | 0 | 10 | 3 | **30.6** |
| 76 | **Dasantila Tahiraj** | PS | 0 | 2 | 1.4 | 12.83 | 3 | 0 | 8.3 | 3 | **30.5** |
| 77 | **Tomor Alizoti** | PD | 0 | 3 | 1.4 | 15 | 4 | 0 | 2.1 | 5 | **30.5** |
| 78 | **Ilirian Pendavinji** | PS | 0 | 2 | 1.4 | 13 | 2 | 0 | 9 | 3 | **30.4** |
| 79 | **Monika Kryemadhi** | LSI | 5 | 3 | 4.8 | 0 | 4 | 0 | 6.5 | 7 | **30.3** |
| 80 | **Besion Ajazi** | PS | 0 | 1 | 1.4 | 12.7 | 2 | 0 | 9.8 | 3 | **29.9** |
| 81 | **Flutura Açka** | PD | 0 | 4 | 3.4 | 8.1 | 6 | 0 | 2.8 | 5 | **29.3** |
| 82 | **Zheni Gjergji** | PD | 0 | 2 | 2.1 | 12.77 | 3 | 0 | 6.1 | 3 | **28.9** |
| 83 | **Merita Bakiu** | PD | 0 | 2 | 2.8 | 11.7 | 2 | 0 | 7.3 | 3 | **28.8** |
| 84 | **Isuf Çelaj** | PD | 0 | 2 | 4.1 | 8.8 | 3 | 0 | 7.8 | 3 | **28.7** |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 85 | **Greta Bardeli** | PD | 0 | 3 | 4.1 | 10 | 3 | 0 | 5.4 | 3 | **28.5** |
| 86 | **Shpresa Marnoj** | PS | 0 | 2 | 2.1 | 10.94 | 2 | 0 | 9.5 | 2 | **28.5** |
| 87 | **Bujar Çela** | PS | 0 | 2 | 0.0 | 11.43 | 2 | 0 | 10 | 3 | **28.4** |
| 88 | **Lindita Buxheli** | PS | 0 | 2 | 2.8 | 10 | 2 | 0 | 9.5 | 2 | **28.3** |
| 89 | **Lindita Metaliaj** | PD | 0 | 2 | 4.1 | 8.9 | 2 | 0 | 8.8 | 2 | **27.8** |
| 90 | **Belind Këlliçi** | PD | 0 | 2 | 2.1 | 10 | 4 | 0 | 2.3 | 7 | **27.4** |
| 91 | **Kastriot Piroli** | PD | 0 | 2 | 3.4 | 9.6 | 2 | 0 | 8.1 | 2 | **27.1** |
| 92 | **Ilir Ndraxhi** | PS | 0 | 1 | 1.4 | 10.5 | 2 | 0 | 10 | 2 | **26.9** |
| 93 | **Gerta Duraku** | PS | 0 | 1 | 0.0 | 11.43 | 2 | 0 | 10 | 2 | **26.4** |
| 94 | **Benet Beci** | PS | 0 | 3 | 0.0 | 7.4 | 3 | 0 | 10 | 3 | **26.4** |
| 119 | **Nustret Avdulla** | PDIU | 0 | 2 | 0.6 | 10.8 | 2 | 0 | 8.8 | 2 | **26.2** |
| 95 | **Bledjon Nallbati** | PD | 0 | 4 | 1.4 | 7.3 | 4 | 0 | 6.1 | 3 | **25.8** |
| 96 | **Lulzim Basha** | PD | 0 | 5 | 5.0 | 0 | 5 | 0 | 3.7 | 7 | **25.7** |
| 97 | **Andia Ulliri** | PLL | 0 | 1 | 2.1 | 10.3 | 2 | 0 | 7.2 | 3 | **25.6** |
| 98 | **Aurora Mara** | PS | 0 | 0 | 1.4 | 10 | 2 | 0 | 10 | 2 | **25.4** |
| 99 | **Damian Gjiknuri** | PS | 0 | 2 | 3.4 | 3.28 | 3 | 0 | 8.6 | 5 | **25.3** |
| 100 | **Ilir Topi** | PS | 0 | 2 | 0.0 | 9 | 2 | 0 | 10 | 2 | **25.0** |
| 101 | **Anduel Tahiraj** | PS | 0 | 1 | 0.6 | 8.1 | 2 | 0 | 10 | 3 | **24.7** |
| 102 | **Jurgis Çyrbja** | PS | 0 | 2 | 0.7 | 5.78 | 2 | 0 | 10 | 4 | **24.5** |
| 103 | **Seladin Jakupllari** | PD | 0 | 2 | 0.0 | 9.99 | 2 | 0 | 7.3 | 3 | **24.3** |
| 104 | **Teuta Ramaj** | PS | 0 | 2 | 0.7 | 7.6 | 2 | 0 | 10 | 2 | **24.3** |
| 105 | **Mesila Doda** | PD | 0 | 3 | 0.7 | 7.21 | 3 | 0 | 7.3 | 3 | **24.2** |
| 106 | **Blendi Klosi** | PS | 0 | 2 | 0.7 | 2 | 0 | 0 | 8 | 3 | **24** |
| 107 | **Shpëtim Idrizi** | PDIU | 0 | 3 | 1.4 | 2.1 | 4 | 0 | 8.3 | 5 | **23.8** |
| 108 | **Niko Kuri** | PS | 0 | 2 | 0.0 | 6.65 | 2 | 0 | 9.8 | 3 | **23.5** |
| 109 | **Flamur Hoxha** | PD | 0 | 5 | 1.4 | 1.8 | 3 | 0 | 7 | 5 | **23.2** |
| 110 | **Tatiana Piro** | PS | 0 | 2 | 0.0 | 6.11 | 2 | 0 | 10 | 3 | **23.1** |
| 111 | **Ramadan Likaj** | PD | 0 | 2 | 2.1 | 5.9 | 3 | 0 | 6.5 | 3 | **22.5** |
| 112 | **Kasëm Mahmutaj** | PD | 0 | 2 | 0.0 | 9.42 | 2 | 0 | 5.4 | 3 | **21.8** |
| 113 | **Saimir Hasalla** | PS | 0 | 1 | 1.4 | 9 | 1 | 0 | 8 | 1 | **21.4** |
| 114 | **Ornaldo Rakipi** | PS | 0 | 1 | 0.7 | 8 | 1 | 0 | 9 | 1 | **20.7** |
| 115 | **Fation Veizaj** | PD | 0 | 3 | 2.8 | 6.6 | 2 | 0 | 3.2 | 3 | **20.6** |
| 116 | **Luan Duzha** | PS | 0 | 1 | 0.0 | 7 | 1 | 0 | 8 | 2 | **19.0** |
| 117 | **Gertjan Deda** | PSD | 0 | 1 | 0.0 | 7.78 | 1 | 0 | 8 | 1 | **18.8** |
| 118 | **Elda Hoti** | PD | 0 | 2 | 3.4 | 3 | 2 | 0 | 5 | 3 | **18.4** |
| 120 | **Meri Markiçi** | PSD | 0 | 1 | 0.0 | 9.3 | 1 | 0 | 6 | 1 | **18.3** |
| 121 | **Paulin Sterkaj** | PS | 0 | 1 | 0.0 | 2.04 | 1 | 0 | 10 | 2 | **16.0** |
| 122 | **Rrahman Rraja** | PS | 0 | 1 | 0.0 | 3.3 | 1 | 0 | 8 | 1 | **14.3** |
| 123 | **Gledis Çeliku** | PSD | 0 | 1 | 0.0 | 5.57 | 1 | 0 | 5 | 1 | **13.6** |
| 124 | **Edi Paloka** | PD | 0 | 2 | 0.0 | 0 | 2 | 0 | 2.8 | 5 | **11.8** |
| 125 | **Alfred Rushaj** | PD | 0 | 1 | 0.0 | 0.8 | 1 | 0 | 2 | 3 | **7.8** |
| **126** | **Agron Çela** | LSI | 0 | 0 | 0.0 | 0.66 | 0 | 0 | 1.4 | 1 | **3.06** |

***Shenim:*** *Deputeti Pandeli Majko u betua në muajin prill 2022. Deputeti Spaho ka -5 pikë për shkak të penalizimit nga Kuvendi.*

## Tabela 2:

## RENDITJA E DEPUTETEVE SIPAS NUMRIT TE FJALIMEVE NE SEANCAT PLENARE JANAR-KORRIK 2022

| NR | Emri dhe mbiemri | Partia | Fjalime |
|---|---|---|---|
| 1 | Petrit Vasili | LSI | 25 |
| 2 | Ina Zhupa | PD | 24 |
| 3 | Taulant Balla | PS | 24 |
| 4 | Bujar Leskaj | PD | 23 |
| 5 | Sali Berisha | PG/PD | 22 |
| 6 | Tritan Shehu | PD | 22 |
| 7 | Jorida Tabaku | PD | 18 |
| 8 | Antoneta Dhima | PS | 17 |
| 9 | Dashnor Sula | PD | 16 |
| 10 | Edmond Spaho | PD | 15 |
| 11 | Enkelejd Alibeaj | PD | 14 |
| 12 | Klotilda Bushka | PS | 14 |
| 13 | Luan Baçi | PD | 14 |
| 14 | Dashamir Shehi | LZHK | 13 |
| 15 | Dhurata Çupi | PD | 13 |
| 16 | Erion Braçe | PS | 13 |
| 17 | Grida Duma | PD | 13 |
| 18 | Kreshnik Çollaku | PD | 13 |
| 19 | Petro Koçi | PS | 13 |
| 20 | Lefter Gështenja | PD | 12 |
| 21 | Saimir Korreshi | PD | 12 |
| 22 | Anila Denaj | PS | 11 |
| 23 | Denis Deliu | PS | 11 |
| 24 | Luçiano Boçi | PD | 11 |
| 25 | Emilja Koliqi | PD | 10 |
| 26 | Ervin Salianji | PD | 10 |
| 27 | Orjola Pampuri | PD | 10 |
| 28 | Toni Gogu | PS | 10 |
| 29 | Vangjel Dule | PBDNJ | 10 |
| 30 | Erisa Xhixho | LSI | 9 |
| 31 | Ermonela Felaj | PS | 9 |
| 32 | Fatmir Mediu | PR | 9 |
| 33 | Sorina Koti | PD | 9 |
| 34 | Vullnet Sinaj | PS | 9 |
| 35 | Albana Vokshi | PD | 8 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 36 | Arbi Agalliu | PD | 8 |
| 37 | Blerina Gjylameti | PS | 7 |
| 38 | Enslemvera Zake | PS | 7 |
| 39 | Etjen Xhafaj | PS | 7 |
| 40 | Flamur Noka | PD | 7 |
| 41 | Klodiana Spahiu | PS | 7 |
| 42 | Lulzim Basha | PD | 7 |
| 43 | Monika Kryemadhi | LSI | 7 |
| 44 | Oerd Bylykbashi | PD | 7 |
| 45 | Pranvera Resulaj | PS | 7 |
| 46 | Eduard Shalsi | PS | 6 |
| 47 | Agron Gjekmarkaj | PD | 6 |
| 48 | Arben Pëllumbi | PS | 6 |
| 49 | Eduard Ndreca | PS | 6 |
| 50 | Eralda Bano | PD | 6 |
| 51 | Etilda Gjonaj | PS | 6 |
| 52 | Fadil Nasufi | PS | 6 |
| 53 | Greta Bardeli | PD | 6 |
| 54 | Ilda Dhori | PD | 6 |
| 55 | Ilir Metaj | PS | 6 |
| 56 | Lindita Metaliaj | PD | 6 |
| 57 | Isuf Çelaj | PD | 6 |
| 58 | Agron Duka | PAA | 5 |
| 59 | Agron Shehaj | PD | 5 |
| 60 | Alban Xhelili | PS | 5 |
| 61 | Damian Gjiknuri | PS | 5 |
| 62 | Elda Hoti | PD | 5 |
| 63 | Florenc Spaho | PS | 5 |
| 64 | Flutura Açka | PD | 5 |
| 65 | Kastriot Piroli | PD | 5 |
| 66 | Mimi Kodheli | PS | 5 |
| 67 | Xhelal Mziu | PD | 5 |
| 68 | Pandeli Majko | PS | 5 |
| 69 | Baftjar Zeqaj | PS | 4 |
| 70 | Fation Veizaj | PD | 4 |
| 71 | Helidon Bushati | PD | 4 |
| 72 | Ismet Beqiraj | PS | 4 |
| 73 | Klevis Xhoxhi | PS | 4 |
| 74 | Laert Duraj | PS | 4 |
| 75 | Lindita Buxheli | PS | 4 |
| 76 | Merita Bakiu | PD | 4 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 77 | Mirela Pitushi | PS | 4 |
| 78 | Nasip Naço | PS | 4 |
| 79 | Andia Ulliri | PD | 3 |
| 80 | Bardhyl Kollçaku | PS | 3 |
| 81 | Belind Këlliçi | PD | 3 |
| 82 | Fatmir Xhafaj | PS | 3 |
| 83 | Ferdinant Xhaferaj | PD | 3 |
| 84 | Gazment Bardhi | PD | 3 |
| 85 | Hatixhe Konomi | PS | 3 |
| 86 | Ramadan Likaj | PD | 3 |
| 87 | Shpresa Marnoj | PS | 3 |
| 88 | Xhemal Qefalia | PS | 3 |
| 89 | Zef Hila | PD | 3 |
| 90 | Zheni Gjergji | PD | 3 |
| 91 | Aurora Mara | PS | 2 |
| 92 | Besion Ajazi | PS | 2 |
| 93 | Dasantila Tahiraj | PS | 2 |
| 94 | Flamur Hoxha | PD | 2 |
| 95 | Ilir Ndraxhi | PS | 2 |
| 96 | Lavdrim Krrashi | PS | 2 |
| 97 | Shpëtim Idrizi | PDIU | 2 |
| 98 | Tomor Alizoti | PD | 2 |
| 99 | Ilirian Pendavinji | PS | 2 |
| 100 | Saimir Hasalla | PS | 2 |
| 101 | Bledjon Nallbati | PD | 2 |
| 102 | Jurgis Çyrbja | PS | 1 |
| 103 | Luljeta Bozo | PS | 1 |
| 104 | Mesila Doda | PD | 1 |
| 105 | Ornaldo Rakipi | PS | 1 |
| 106 | Teuta Ramaj | PS | 1 |
| 107 | Blendi Klosi | PS | 1 |
| 108 | Anduel Tahiraj | PS | 1 |
| 109 | Nustret Avdulla | PDIU | 1 |
| 110 | Agron Çela | LSI | 0 |
| 111 | Alfred Rushaj | PD | 0 |
| 112 | Benet Beci | PS | 0 |
| 113 | Bujar Çela | PS | 0 |
| 114 | Edi Paloka | PD | 0 |
| 115 | Gerta Duraku | PS | 0 |
| 116 | Gertjan Deda | PSD | 0 |
| 117 | Gledis Çeliku | PSD | 0 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 118 | Ilir Topi | PS | 0 |
| 119 | Kasëm Mahmutaj | PD | 0 |
| 120 | Luan Duzha | PS | 0 |
| 121 | Meri Markiçi | PSD | 0 |
| 122 | Niko Kuri | PS | 0 |
| 123 | Paulin Sterkaj | PS | 0 |
| 124 | Rrahman Rraja | PS | 0 |
| 125 | Seladin Jakupllari | PD | 0 |
| 126 | Tatiana Piro | PS | 0 |

## MBI INSTITUTIN E STUDIMEVE POLITIKE

Instituti i Studimeve Politike (www.isp.com.al) është një organizatë e shoqërisë civile që vepron në fushën e demokratizimit dhe shtetit të së drejtës. Drejtor Ekzekutiv aktual është Prof. Afrim Krasniqi.

ISP është e fokusuar në monitorimin e institucioneve demokratike, si dhe në hartimin e raporteve / analizave profesionale mbi problematika specifike politike me interes për qytetarët, shoqërinë dhe partnerët ndërkombëtarë. Pjesë e ISP janë ekspertë të njohur të zhvillimeve politike dhe të drejtësisë, të marrëdhënieve ndërkombëtare dhe të marrëdhënieve publike. ISP publikon vazhdimisht raporte monitoruese.

## DISA NGA PROJEKTET KRYESORE TE REALIZUARA VITET E FUNDIT NGA ISP:

- Database www.deputetim.al mbi monitorimin e Kuvendit të RSH (2017-vijon)
- Database http://dekriminalizimi.isp.com.al/ mbi integritetin në politikë (2017-vijon)
- Database online www.muzeuimemories.info Shqipëria në periudhën komuniste (2016-vijon)
- Database www.politike.al mbi partitë politike, zgjedhjet, organizimin e tyre (2016-2019)
- Monitorim të reformës në drejtësi (2016 - vijon)
- Monitorimin e ligjit të dekriminalizimit dhe konfliktit të interesit në politikë (2017 – vijon)
- Monitorimin e demokracisë së brendshme në partitë politike (2015-vijon)
- Monitorimin e reformës zgjedhore (2017-vijon)
- Monitorim i progresit të Shqipërisë drejt BE (2018-vijon)
- Monitorimi i memories historike ndaj të kaluarës (2016 – vijon)
- Monitorim i zonave zgjedhore të riskut elektoral (2017 – vijon)
- Monitorimi i përfaqësimit të grave në partitë politike (2015, 2017, 2019, 2021)
- Monitorim të çështjeve që lidhen me emigracionin / diasporën (2018 - vijon)
- Monitorimin e ligjit mbi të drejtën e informimit (2014-2018)
- Monitorim i qeverisjes vendore (2016-2020)

- Raporti do t'u shpërndahet në rrugë elektronike dhe të printuar të gjithë deputetëve në parlament, partive politike parlamentare, partnerëve të ISP, ekspertëve të angazhuar, si dhe mediave kryesore.

- Të gjitha publikimet e ISP që lidhen me projekte kombëtare e ndërkombëtare (libra, studime, policy paper, raporte, etj) jepen falas për çdo të interesuar, si dhe publikohen në faqen zyrtare të ISP në formë të përmbledhur)

- Për çdo interes, sugjerim apo informacion, mund të kontaktoni në çdo kohë ISP përmes adresës zyrtare, emailit, faqes së internetit, adresave të ISP në rrjetet sociale, etj.

Web: www.isp.com.al
Email: contactaips@isp.com.al dhe contactaips@gmail.com
Facebook: Instituti i Studimeve Politike / Institute for Political Studies
Adresa: Rr "Luigj Gurakuqi", Shk. A, P.89 K.3, Ap 16, Tiranë

**CIP Katalogimi në botim BK Tiranë**

**Instituti i Studimeve Politike**
Aktiviteti parlamentar dhe cilësia e përfaqësimit raport monitorimi i Kuvendit 2022/ Instituti i Studimeve
Politike ; drejtues i projektit Afrim Krasniqi. – Tiranë :
Instituti i Studimeve Politike, 2022
... f. ; ... cm.
ISBN 978-9928-4694-7-2
1.Parlamenti Shqiptar 2.Monitorime 3.Raporte 4.Shqipëri

328(496.5) "2022" (047)